Punonjësit e klinikës janë më kontakt të vazhdueshëm me lëndë të ndryshme mijekuese, të cilat njihen si lëndë me veti, antigjenike. Megjithëse në kohën kur u përcaktua eozinofilia, ata nuk kishin shfaqje alergjike në lëkurë, ata kishin një mesatare prej 760 eozinofile/ mm^3 në gjakun periferik, ose 190,7% në krahasim me atë të studentëve. Në anamnesë zën e punonjësve që kemi marrë më studim ka prej tyre me ndjeshmëri të lartë (reaksion alergjik) nga aspirina, piramidonë, streptomicita, vatra kloronike infektive etj. Numri më i ulur i eozinofileve ka qenë 466, kurse më i larti 1144.

Në 15 punëtorë të ndërmarrjes së ndërtimit mesatja e eozinofileve ishte edhe më e lartë (793), e barabartë me 204,1% në krahasim me atë

të studentëve. Ata janë në kontakt me ilaç, me çimento, me gjigjere, me ranë etj., kurse mekanikët janë në kontakt me prodhimë të ndryshme të naftës. Në 7 punëtore edhe provat e lëkurës (fester) me disa lëndë, me të cilat punojnë, kanë dëla pozitiv, sikurse edhe testi autoleukocitar. Asnjëri prej këtyre punëtoreve nuk e ka pasur numrin e eozinofileve më të ulur se 400. Numri më i ulët ka qënë 433, kurse më i lartë 1042. Punëtoret që kanë pasur edhe provat e tjera të lëkurës pozitiv kishin eozinofili edhe më të lartë. Në kohën kur janë përcaktuar eozinofilet, disa prej tyre kishin dëmattë alergjik apo ekzemë të duarave. Punëtoret e ndërmarrjes kimike, që merren me prodhimin e lëndëve deteritive (lëndë larëse sintetike – pluhurat e ndryshme larëse), megjithëse nuk kishin shifraqe të shprehura alergjike, lëkura e duarve të tyre ishte e thafë, e ashper për dëme deskuamim të lëntë dëhe të imët. Shumë pak prej tyre vuanin nga ekzema e duarve. Mesatarja e 6 punëtoreve të kësaj ndëmarrjeve ishte 54, ose 141,1% në krahasim me mesataren e studentëve, tigjetë të ndryshëm njerezish.

Në pasqyrën nr. 1 paraqesim vlerën mesatare të kontrollit në kon-

Pasqyra nr. 1

Kontigjenti	Nr. i rasteve	Nr. më i ulët	Nr. më i lartë	Mesatarja	Përqindja
Studentë	52	211	910	388	100
Punëtore të klinikës	11	466	1144	760	190,7
Punëtore të ndërtimit	15	433	1042	793	204,1
Kimike	68	244	1333	548	141,1
Për të tre grupet punëtore	94	244	1333	601	154,8

Të bazuar në 52 studentë të dytë 94 punëtore mund të nxjerim dy mesatare kontrolli. E para Për studentët, të cilët janë kontigjentet që kanë shumë pak të bëjnë me faktorë të ndryshëm alergjizues. Në këtë kategori mund të hyjnë edhe nxënësit, nëpunësit etj., të cilët, në punët e tyre të përditshme, nuk kanë kontakt me lëndë alergjizuese. Në këtë kontigjent njerezish, mesataren e kontrollit, siç e thamë më lart, po e marrim me 400.

Mesatarja e dytë e kontrollit, baraz me 600, i përket asaj kategori punonjeshin që, në punën e tyre të përditshme, janë në kontakt me alergjienë, por që nuk kanë shifraqe të ndryshme aktive alergjike në lëkurë.

Për të përcaktuar ndjesimërinë e ngritur të organizmit nga lëndë ndryshme alergjike, përdoren metoda të ndryshme, ndërmjet të cilave edhe percaktimi i eozinofileve në gjakun periferik dëhe vratat e dëmtuara të lëkureve apo të cipave jargore. Ne përcaktuam numrin e eozinofileve në gjakun periferik në një të sëmëruar të klinikës me ekzamë dherëmatt. Për të parë ndryshimet e eozinofileve në njerez të shëndoshë (studentë) në krahasim me të sëmuret, bëmë edhe përpunimin statistikor

të të dhënave të eozinofileve. Në pasqyrat nr. 2 dhe 3 po jepim të dhënat e këtij përpunimi.

Pasqyra nr. 2

Kontigjenti	Nr. i rasteve	Mesatarja	n	P	Rëndësia e ndryshimit
Studentë	52	388	$\pm 142,3$	$\pm 19,76$	
Ekzeme	40	791	$\pm 230,9$	$\pm 36,55$	0,001 i rëndësishëm

Në të sëmurët me ekzamë, numri më i ulët i eozinofileve ka qënë 372, kurse më i larti 1333, me një mesatare 791. që në krahasim me mesataren e studenteve, është 203,8% më e lartë. Për të vërtetuar se ky ndryshim në mesataren e eozinofileve nuk është i rastit logarifëm edhe $p < 0,001$, që tregon se ndryshimi i eozinofileve midis studenteve dhe të sëmurëve me ekzemë është i rëndësishëm. Në diagnostikimin e ekzemes, në të sëmurët me ekzemë ky ndryshim duhet marrë parasysh. Rritja numerike tregon se tek të sëmurët me ekzemë, kur ajo gjendet në fazën akute apo të riakutizuar, siç kanë qënë të sëmurët tanë, në organizmin e tyre ndodhin ndryshime alergjike. Ndeshshmëria e ngritur e organizmit në të sëmurët me ekzemë nga alergjenë të jashtëm apo të brendshëm shoqërohet edhe me pjesëmarrijen e sistemit hemopoetik. Pra, eozinofilia në të sëmurët me ekzemë është një tregues që duhet marrë parasysh në diagnostikimin e ekzemes.

Përkaktimi i eozinofiliës edhe në vatrat e dëmtuara, si dhe ndryshimet e numrit të tyre në fillim të sëmundjes, gjatë mjejkimit dhe në fazën e qetësimit të procesit, do të vërtetojë edhe më drejt pjesëmarrijen e eozinofileve në proceset ekzematoze, si dhe në ndryshimet alergjike lokale në këtë sëmundje.

Përkaktimin e numrit të eozinofillëve e kemi kryer dhe në të sëmurë me dermatit dhe bëmë edhe përpunimin statistikor me studentët (snih pasqyrën nr. 3).

Pasqyra nr. 3
Përpunimi statistikor i eozinofileve në studentë dhe të sëmurë me dermatit

Kontigjenti	Nr. i rasteve	Mesatarja	n	P	Rëndësia
Studentë	52	388	$\pm 19,76$	$\pm 19,76$	—
Dermatit	17	891	$\pm 161,53$	$\pm 61,53$	0,001 i rëndësishëm

Në dermatite, mesatarja e thjeshtë e eozinofileve është 891, që, në raport me atë të studenteve, është 252,3%. Në këta të sëmurë, numri më i ulur i eozinofileve është 344, kurse më i larti 1276. Nga përpuni-

mi statistikor rezultoi propabilitytin $p = < 0,001$, gjë që tregon se ndryshimi ndërmjet eozinofilisë së studentëve dhe të dermatiteve është i rëndësishëm jo rastësht që duhet pasur parasysh në diagnostikimin e dermatitit. Kjo tregon se në dermatit ndodh shërimi i numrit të eozinofileve, si rezultat i ndryshimeve alergjike në organizëm.

Në përpunimin statistikor të të dhënave në të sëmurët me ekzemë dhe dermatit, rezultoi se $p > 0,05$, gjë që tregon se ndryshimi i eozinofileve midis këtyre dy gjendeve patologjike nuk është i rëndësishëm dhe nuk dhet të merret parasysh.

PERFUNDIME

- 1) Numri i eozinofileve në gjakun periferik në studentë është 400, kurse në punëtorë, pa shfaqje aktive alergjike në lëkurë, është 600 për 1 mm^3 të gjakut periferik.
- 2) Diferencia e eozinofilisë në ekzema dhe dermatit, në krahasim me studentët, është i rëndësishëm dhe duhet marrë parasysh.
- 3) Eozinofilia është një treguese e rëndësishme për ndryshimet alergjike në organizëm.

Dorëzuar në Redaksi më 10 prill 1979

BIBLIOGRAFIA

- 1) Ado A. D.: Obshčaja alergologija. Moskva 1970, 299.
- 2) Cina P.: Një rast me eozinofili të lartë. Buletini i UT — seria shkencat mjekësore 1965, 2, 73.
- 3) Golshttein L. M., Golshttein E. I.: Obshčaja i mestnaja eozinofilia pri alergičeskih zudishticëm dermatozah. Vest. Der. Ven. 1972, 3, 93.
- 4) Lovisetto P. e bpr.: Eozinofili ed ipereosinofili del sangue. Torino 1972, 35.
- 5) Pavlo P.: Shock anaflaktik mortal nga bipenicilina në persona me astmë alergjike nga medikamente. Buletini i UT — seria shkencat mjekësore 1961, 4, 87.
- 6) Rajka E., Korossy S.: Immunol aspects of allerg. and allerg. disease 1976, Vol. 7, 11.
- 7) Tuft L.: Allergy management in clinical practice. Saint Louis 1973, 31.

Summary

THE FORM OF THE EOSINOPHILES AND EOSINOPHILIA IN SOME ALLERGIC SKIN DISEASES.

The average number of eosinophile cells in the peripheral blood of healthy students was found to be 400 per cubic millimeter, while in workers with no clinical signs of eczema or dermatitis it was 600. In patients with eczema or dermatitis the average number of eosinophile cells resulted 791 and 813 respectively. The probability of these two allergic conditions (P) is less than 0.001.

The increased number of eosinophile cells in the peripheral blood indicates their participation in the allergic processes and the increased sensitivity of the organism in these diseases towards various substances with antigenic properties.

Résumé

LA FORME DES EOSINOPHILES ET DE L'EOSINOPHILIE DANS CERTAINES MALADIES ALLERGIQUES DE LA PEAU

Le nombre moyen des éosinophiles dans le sang périphérique des étudiants était de 400 par mm³, tandis que chez des ouvriers ne présentant pas des signes d'eczéma ou de dermatite il était de 600 mm³. Chez les patients souffrant d'un eczéma ou d'une dermatite, on a relevé respectivement 791 et 813 éosinophiles. La probabilité de ces deux conditions allergiques (p) inférieure à < 0.001 .

L'accroissement numérique des éosinophiles dans le sang périphérique montre la participation de ceux-ci aux processus allergiques et une plus grande sensibilisation de l'organisme pendant ces maladies à l'égard des différentes substances ayant des propriétés antigéniques.

HULUMTIMI I METABOLIZMIT TE KATEKOLAMINAVE NE SEMUNDJEN E HIPERTONISE

— SIRI LESKOVIKU —

(Laboratori Biokimik Qendror. Spitali nr. 1 Tiranë)

Hulumtimet e sotme në fushën e sëmundjes hipertoniqe dhe hipertonise simptomatike kanë vënë në dukje çregjullimin e formave të ndryshme të proceseve të metabolizmit. Studimi i proceseve të metaboliqmit gjatë sëmundjes hipertoniqe dhe sëmundjeve me sindroma hipertensive ka rëndësi jo vetëm nga pikëpamja e ndryshimeve patogjenetike të këtyre gjendjeve, por edhe në zgjidhjen e problemeve të diagnostës diferenciale dhe të injekimit.

Krahas studimit të metabolizmit lipidik, elektrolitik dhe ndryshimeve renale (1, 2, 6, 7), rëndësi paraqet dbe studimi i faktoreve neuro-endokrinë, që marrin pjesë në rregullimin e procesin metabolik të përmëndur dhe, për posojë, në patogjenezin e sëmundjes hipertoniqe. Sistemi simpatiko-adrenalinik dhe hormonet e tij luajnë rol kryesor në rregullimin e tensionit arterialis. Normalisht, një pjesë e adrenalinës dhe noradrenalinës endogjene nuk i nënshtronet metabolizmit ndërmjetës, por eliminohet drejtëpërdrejt në formë të lire ose të lishur. Për këtë, sasia e ekskretuar e tyre, e përcaktuar në mënyrë sasijore, jep mundësi të gjithashtu mbi gjendjen funksionale të sekretimit të këtyre hormoneve prej organizmit si dhe mbi gjendjen funksionale të sistemit simpatik dhe të pjesës medulare të gjendrave mbiveshkore (8, 10).

Roli i katekolaminave në metabolizëm eshtë i shumëllojshëm. Veprimi i shumanshëm dhe i shprehur i tyre në metabolizmin e glucideve dhei lipideve e bën interesant rolin e katekolaminave në patogjenezin e sëmundjeve, që lidhen me çregjullimet e këtyre formave të metabolizmit dhei gjithashtu mbi rëndësinë diagnostike të përcaktimit të tyre në sëmundjen e hipertoniqe.

Rëndësi të madhe për patogjenezin e sëmundjes hipertoniqe soft u jepet faktorëve humorale dhe, në veçanti, atyre endokrine. Një rdhë autorësh i japin rol kryesor sistemit simpatiko-adrenalinik në patogjenezin e sëmundjes hipertoniqe. Kështu, disa autorë (cituar nga 5, 9) janë të mendimit se gjatë sëmundjes hipertoniqe ka rritje të funksionit të shpreses medulare të gjendrave mbiveshkorë ose hiperfunkcionit të pjesës simpatike të sistemit nervor.

Mbi rolin e katekolaminave në patogjenezin e sëmundjes hipertoniqe, në literaturë ka të dhëna në kundërshtim njëra me tjetrën:

Megjithatë, munësia e ndryshimeve të theksuara në përbaltjen

e katekolaminave në gjak dhe në urinë gjatë sëmundjes hipertoneke nuk e ul rolin e tyre në patogjenezin e kësaj sëmundje. Por ndonëse deri më sot mbetet i diskutueshëm roli i katekolamineve në patogjenezin e sëmundjes hipertoneke, eliminimi me urinë i katekolaminave mbetet një nga treguesit më objektivë për të vlerësuar gjendjen funksionale të sistemit simpatiko-adrenalik dhe të ndikimit të çrrregullimeve të këtij sistemi në shfaqjen e sëmundjes hipertoneke.

Ne studjuam ndryshimet e adrenalinës dhe noradrenalinës në 120 të sëmure me sëmundje hipertoneke, të shtruar në klinikën nr. 3 të spitalit nr. 1. Të ndarë sipas stadiut të sëmundjes hipertoneke, 54 i përkismin stadin të parë, 53 stadin të dytë dhe 13 stadin të tretë.

Dozimi i katekolaminave urinare u bë me metodën e fluorescencës të modifikuar në laboratorin biokimik qendror (3). Matjet fluorometrike janë bërë me fluorometrin Turner, duke përdorur si filtrë primar 365 nm dhe filter sekondar 510 nm. Përsa u përkët vlerave normale të katekolaminave urinare, autorë të ndryshëm janin vlera të ndryshme. Përkëtë arsyen, autorë i nisur dha nga fakti se metodën e dozimit të katekolaminave e kemi modifikuar, e pamë të nevojsime të bëjmë përcaktimin e tyre në një grup kontrolli. Si grup kontrolli u morën 16 njerëz të shëndoshë në moshë 22-48 vjeç (4).

Në pasqyrën nr. 1 e 2 festohë paraqitur numri i rasteve, vlera mesatare satare dhe devijimi standart i katekolaminave urinare në grupin e kontrollit dhe në stadin e parë, të dytë e të tretë të sëmundjes hipertoneke.

Pasqyra nr. 1

Numri i rasteve, vlera mesatare dhe devijimi standart i adrenalinës në grupin e kontrollit dhe në të tre staden e sëmundjes hipertoneke në MCg/24 orë.

	N	M ± DS	P	P ₁
Grupi i kontrollit	16	7.3±3.9		
Stadi i I	54	19.7±15.2	<0.01	
Stadi i II	53	21.5±18.2	<0.01	>0.05
Stadi i III	13	20.2±17.4	<0.01	>0.05

Pasqyra nr. 2

Numri i rasteve, vlera mesatare dhe devijimi standart i noradrenalinës në grupin e kontrollit dhe në të tre staden e sëmundjes hipertoneke në MCg/24 orë.

	N	M ± DS	P	P ₁
Grupi i kontrollit	16	27.0 ± 9.0		
Stadi i I	54	31.6 ± 19.4	<0.001	
Stadi i II	53	29.2 ± 17.0	>0.05	>0.05
Stadi i III	13	28.5 ± 16.2	>0.05	>0.05

Duke iu referuar të dhënave të paraqitura në pasqyrën nr. 1, shihet se adrenalina në stadin e parë, të dytë dhe të tretë është më e rritur se tek grupi i kontrollit ($P < 0.01$). Ndërsa nga pasqyra nr. 2 vërehet se noradrenalina rritet vetëm në stadin e parë të sëmundjes hipertoneke ($P < 0.001$), kurse në stadin e dytë është ajo nuk ndryshon nga grupi i kontrollit ($P > 0.05$). Përgjithësisht, të dhënat e paraqitura në pasqyrën nr. 1 dhe 2 dëshmojnë mbi atë se eliminimi i katekolaminave urinare, vëcanërisht i adrenalinës në sëmundjen hipertoneke, është më i shtuar se në njëzetë e shëndoshë. Nga këto të dhëna duhet bërë dhe konkluzioni se në sëmundjen e hipertoneje, tonusi i sistemit simpatiko-adrenalinik është i rritur në krahasim me njëzetë e shëndoshë.

Duke kaluar nga njëri stadi në tjetrin shihet se nuk ka ndryshime në eliminimin urinar si të adrenalinës ashtu dhe të noradrenalinës ($P_1 > 0.05$). Pra, si në stadin e pare, të dytë dhe të tretë, eliminimi në urinë i katekolaminave është i pandryshueshëm. Gjithashtu të dhënat tona venë në dukje se nuk ka paralelizëm ndërmjet tensionit arterial të rritur dhe nivelit të katekolaminave urinare të eliminuara.

PERFUNDIME

- 1) Në të tre stadiet e sëmundjes hipertoneke, eliminimi i adrenalines me urinë është më i shtuar se në njëzetë e shëndoshë.
- 2) Noradrenalina rritet vetëm në stadin e parë të sëmundjes hipertoneke, ndërsa në stadin e dytë dhe të tretë, vlera e saj nuk ndryshon nga ajo e njëzetë e shëndoshë.
- 3) Në sëmundjen hipertoneke, tonusi i sistemit simpatiko-adrenalinik është i rritur në krahasim me njëzetë e shëndoshë.
- 4) Duke kaluar nga njëri stadi i sëmundjes hipertoneke në tjetrin nuk vihet re ndryshim në eliminimin e katekolaminave urinare.
- 5) Ndërmjet tensionit arterial të rritur dhe nivelit të katekolaminave urinare të eliminuara nuk ka paralelizëm.

Dorëzuar në Redaksi më 28 prill 1979

BIBLIOGRAFIJA

- 1) Adhami J.: Ndryshimet renale në të sëmurët me Morbus hypertensionis. Shëftekëstori popullore 1966, 4, 11.
- 2) Bytykbasni V., Leskoviku S., Rusi H.: Aspekte të ndryshme biokimike në sëmundjen e hipertoneje sipas materialit të klinikës hospitaliere. Shëftekëstia popullore 1976, 4, 67.
- 3) Leskoviku S.: Përcaktimi i adrenalines dhe noradrenalinës me metodën e fluorescencës. Buletini i UT-Seria shkencat mjekësore 1974, 1, 237.
- 4) Leskoviku S., Buzo S.: Të dhëna paraparakre mbi rritjen normale të disa anormale hormonale. Buletini i UT-Seria shkencat mjekësore 1977, 2, 67.
- 5) Moga V.: Hipertensione arteriale si arterosclerosa. Editura medicale, Bucuresti 1970, 47.
- 6) Rusi H. e bpr.: Të dhëna mbi ndryshimet renale hipertoneke esenciale. Shëftekëstia Popullore 1975, 4, 44.
- 7) Selimaj E.: Të dhëna mbi gjindjen e elektroliteve në urinën e të sëmurrëve me hipertoni esenciale. Punime mbi sëmundjet e brendshme 1976, 1, 14.

- 8) Spandrio L.: Analisi biochimico-cliniche. Padova 1972, 330.
 9) Shevchenko B. I.: Giperfunkcional'naja bolezna, ateroskleroz i koronarnaja nje-dostatçnost. Kiev 1967, 36.
 10) Varley H.: La diagnozi di laboratorio nella pratica clinica. Roma 1969.

Summary

INVESTIGATION IN THE METABOLISM OF CATECHOLAMINES IN THE HYPERTENSIVE DISEASE

A study was carried out of the changes in the secretion of adrenaline and noradrenaline on 120 patient in various stages of the hypertensive disease. Of these, 54 were in the first stage, 53 in the second and 13 in the third stage. The determination of the catecholamines was carried out by the technique of fluorescence. In all three stages of the illness the secretion of adrenaline is higher than in normal persons. The secretion of noradrenaline rises only in the first stage, while in the second and third stages it is similar to that of normal subjects. In the hypertensive disease, the tonus of the sympathetico-adrenalinic system is higher than in normal people.

No changes were observed in the urinary excretion of catecholamines during the passage from one stage to the other.

In this work the author has noted no parallelism between the level of the blood pressure and the urinary excretion of catecholamines.

Résumé

INVESTIGATION DU MÉTABOLISME DES CATECHOLAMINES DANS LA MALADIE DE L'HYPERTENSION

L'auteur du présent article a étudié les modifications enregistrées par la sécrétion de l'adrénaline et de la nor-adrénaline chez 120 patients dans les différents phases de la maladie de l'hypertension. De leur nombre, 54 se trouvaient à la première phase, 53 à la seconde et 13 à la troisième. La détermination des catecholamines a été effectuée selon la technique de la fluorescence. Dans toutes les trois phases de la maladie, la sécrétion de l'adrénaline est supérieure à celle observée chez des sujets sains. La sécrétion de la nor-adrénaline croît seulement dans la première phase, alors que dans la deuxième et troisième phase elle est égale à celle des sujets normaux. Dans la maladie de l'hypertension, le tonus du système sympathique-adrénnalique est plus élevé que celui observé chez des sujets normaux.

Pendant le passage d'une phase à l'autre de la maladie, on n'a pas observé des modifications dans l'élimination des catecholamines à travers l'urine.

Dans cette communication l'auteur indique qu'il n'a relevé aucun parallélisme entre le niveau de la pression artérielle et des catecholamines éliminées à travers l'urine.

HIGJENE DHE EPIDEMIOLOGI

ENTEROBAKTERIACETE E VEÇUARA NË INFJEKSIONET URINARE DHE NDJESHIMERIA E TYRE NDAJ STREPTOMICINES DHE TETRACKLINES

— ESAT DURAKU —

(Instituti i Kërkimeve të Mjekësise Ushtrake)

Shumica e infeksioneve urinare që hasen në praktikën e zakonshme shkaktohen nga Enterobakteriacete (1, 2, 9). Duke u bazuar në një material të rendësishëm të përbërë nga 856 shtame, disa autorë (2) prouvuan se 733 (85,6%) ishin përfaqësues të familjes së Enterobakteriaceve. Përkrahësht rralle hasen infeksionet urinare të shkaktuara nga Staphylococcus aureus (plazmokutagulaz +), Streptococcus i grupeve D (Enterococcus) dhe B, Pseudomonas aeruginosa (B. Pyocyaneum), Mycobacterium tuberculosis, Candida etj. (1, 2).

Kjo strukturë etiologjike shpjegohet kryesisht me faktin se infeksionet urinare të origjinës hematogjene janë të rralle, ndërsa të zakhshme janë infeksionet ashendente, nëpërmjet uretrës; mikrobet intestinale, pjesëtarë të familjes së Enterobakteriaceve, sidomos Escherichia coli dhe Proteus mirabilis, ndotin perineumin dhe arrinë jo rrallë të depërtojnë në vezikën urinare nëpërmjet uretrës. Brugën ashendente ndiekjan gjithashu infeksionet jatrogjene të shkaktuara nga eksplorimet instrumentale, sondimet apo ndërhyrjet kirurgjikale, por në këto raste, krahas Enterobakteriaceve (Proteus, reitgeri e norgani, Klebsiella, Enterobacter dhe Serratia) nji rol po aq të rendësishëm luajnë *Staphylococcus aureus* dhe *Pseudomonas aeruginosa*.

Diagnoza bakteriologjike e infeksioneve urinare për shumë kohë është njollsur nga gabimet e shkaktuara nga ndotja e urinës me florën mikrobiike uretrale ose perineale. Megjithatë, shumica e kërkuesve kanë arritur sot në përfundimin se një bakteriuri monomikrobike sinjifikative në urinën e mëngjezit, të narrë gjatë rrjedhës së dyte, përijashton ndotjet e rastit dhe flet për një infeksion urinar. Përcaktimi i një kuifiri numerik të vlefshëm nga pikëpamja statistikore për të dalluar infeksionet e vërteta nga ndotjet e mundshme eshtë diskutuar gjithësisht. Në 95% të rasteve me infeksione urinare të sığurta, në urinë zbulohen 100.000 mikrobe ose më shumë për mililitër. Eshtë e padiskutueshme se në disa raste të infeksioneve urinare, numri i mikrove është më i vogël, por këto nuk e kalojnë shifrën 5%; shifrat që mund të konsiderohen si të dyshimita dhe që duhen verifikuar nëpërmjet disa ekzaminimeve të përsëritura janë 10^4 - 10^5 (1, 2, 8, 9).

Meqëmës pjesëtarët e familjes së Enterobakteriaceve janë shkaktarët kryesore të infeksioneve urinare të hasura në praktikën mjekësore të përditshme, i vumë vetes si qëllim, që, duke u mbështetur në

një identifikim të kujdeshëm, të përcaktuan me përpikmëri ndjeshmërinë e tyre ndaj antibiotikëve streptomicinë dhe tetraciklinë, duke u bazuar në rezultatet e përqëndrimeve minimale frenuese.

MATERIALI DHE METODAT

Materiali përbëhet nga 144 shtame të izoluar gjatë viteve 1970-1972, të cilët për nga vettitë e tyre morfollogjike, kulturale e biokimike i përkasin familjes së Enterobakteriaceve. Të gjitha këto shtame janë izoluar në persona të rritur me një bakteriuri të lartë prej 10^5 ose më shumë mikrobe për mililitër urine.

Urina e mëngjedjt nga rrjedha e dytë është mbledhur në tuba stërike. Për të mënjanuar në maksimum kontaminimet e rastit, para arrjes së urinës, është rekomanduar gjithnjë larja shumë e kujdeshme e organeve të jashtme gjennitale me ujë dhe sapun dne fshirja e tyre me një copë të pastër e të hekurosur.

Mëqëndrsës urina është një terren i përshtatshëm për shumëzimin e mikrobeve, mbjelljet janë bërë pa votësë. Kur mbjellja e shpejtë nuk ka qënë e mundur, kampionet janë ruajtur në frigorifer. Janë bërë mbjellje paralele të agar gjak dhe Endo. Përcaktimi i numrit mikrobi për militër urinë është bërë sipas teknikës së rekomanduar nga Gould (cituar nga 8).

Për identifikimin e Enterobakteriaceve jemi mbështetur në vettitë e tyre të ngjyrimit (bakterie gramnegative), në karakteristikat e rrjetës së kolonive në terrenet e laripërmëndura dhe në një kompleks të gjëre provash biokimik që jepen në pasqyrrën nr. 2. Teknikat biokimike të përdorura kanë qënë të njëjtë me ato që janë përshtkuar në një publikim tonë të mëparshëm (3). Identifikimi serologjik është bërë vetëm për grupin Alkalescens-Dispar me anën e seruimeve përkatëse aglutinuese. Identifikimi biokimik është mbështetur në të dhënat e disa autoreve (5, 6, 7).

Ndjeshmëria ndaj antibiotikëve streptomicinë, dbe tetraciklinë është përcaktuar me metodën e hollimeve në agar-plaqë. Me këtë metodë arrinhet të përcaktohet koncentrimi minimal frenues (KMF-a) i një antibiotiku për një shtam të ekzaminuar. Hollimet e antibiotikëve, terrenet dhe inokulimi i përdorur kanë qënë të njëjtë dhe janin me hollesi në një punim të mëparshëm (4).

Për streptomicinën si rezistentë u vlerësuani shtamet që kishin një KMF më të lartë se 100 mcg/ml, mesatarisht të ndjeshëm ata me KMF \leq 25 mg/ml dhe 100 mcg/ml dbe të ndjeshëm ata me KMF \leq me 12,5 mcg/ml; ndaj tetraciklinës u konsideruan rezistentë shtamet me KMF \geq 100 mcg/ml, mesatarisht të ndjeshëm shtamet me KMF \geq 25 dbe 50 mcg/ml. dbe të ndjeshëm shtamet me KMF \leq 12,5 mcg/ml. (1, 10).

REZULTATET

Nga 144 shtame Enterobakteriace të vëguara në infekzionet urinare, pjesa më e madhe e tyre – 104 (72,2%) qenë Escherichia, 19 (13,2%) – Proteus dhe pastaj më rrallë u izoluan përfaqësues nga,

gjintë Enterobacter (7,6%), Klebsiella (4,9%) dhe Citrobacter (2,1%).
Të dhëna më të hollësishme jepen në pasqyrën nr. 1.

Pasqyra Nr.1: Enterobakteracetë e vecuara në infekzionet urinare.

Escherichia coli	Enterobacter	Proteus	Citrobacter
Shtame	Klebsiell escherichia colic	cloacae	aerogenes liquefaciens mirabilis morgani rettgeri
Shpërndarja e shtameve si numur	101	3	17
%	40,1	2,1	1
% permblekje	72,2	4,9	13,2
		7,6	2,1

Jepen në pasqyrën nr. 2. Kompleksi i gjërë i testeve biokimikë të përdorur bëri të mundur inkudrimin përkrahësht të lehtë të shtameve të veguar në gjintë e tyre përkatëse. Shtamet e Escherichia coli, që përbënë shumnicën, patën këtë karakteristikë biokimike:

— Asnjë shtam nuk zhëtue urenë, nuk prodhoi acetylmetilkarbonil apo H₂S, nuk shkru xhelatinën, nuk shfrytëzoi malonatin dhe as nuk dezaminoi fenilalaninën, vetëm njëri prej tyre u rrit në Simmons citrate agar;

— Pothuajse të gjithë shtamet (me përiashëmë tepër të rralla) prodhuan indol dhe dekarboksiliuan aminoacidet lizinë, argininë dhe ornitinë;

— Të gjithë shtamet fermentuan maltozën, manitin e trehalozën; pothuajse të gjithë shfrytëzuan laktozën, ramnozën, arabinozën, ksilozën dhe sorbitin dhe një pjesë e mire fermentoi saharozën, dulcitin, salicinin dhe rafinozën. Adoniti dhe inoziti u prekën shumë rraile. Nga 101 shtame – 98 ishin gazogjenë.

Shtamet e Proteus mirabilis, që renditen të dytët përsa i takon frekuencës, qenë të njërrajshëm në sjelljen e tyre biokimike. Veti të biokimikë të shtameve jepen me hollësi në pasqyrën nr. 2. Duhet të theksojmë se reakSIONET e grupit Klebsiella-Enterobakter ndaj aminoacidave lizinë, argininë dhe ornitinë nuk janë tipike për ta. Kjo gjë lindhet me faktin se ne përdorim teknikën e rekombinuar nga Falkow. Reaksionet e këtij grupi, kur përdoret kjo teknikë, nuk janë tipike (5).

Shpërndarja e shtameve sipas sekst jepet në pasqyrën nr. 3. 94 shtame (65,3%) u vegun në femra dhe 50 shtame (34,4%) në meshkuj.

Të dhënët e kësaj pasqyre tregojnë një frekuencë më të lartë të Escherichia coli (76,6%) në femra në krahësim me meshkujt (58%). Di-

Pasqyrë Nr.3: Shpërndaria e shtameve sipas sekst.

	Escherichia coli	Klebsiella	Enterobacter	Proteus	Citrobacter	Shumë
F E M R A	72 (76,6%)	3 (3,2%)	2 (2,1%)	3 (3,2%)	2 (2,1%)	E. liquefaciens E. aerogenes E. mirabilis P. morgani P. rettgeri
M E S H K U J	29 (53%)	0 (0%)	2 (4%)	1 (2%)	0 (0%)	(18%) (2%) (6%) (34,2%)

ferenca ndërmjet këtyre treguesve është e rëndësishme nga pikëpamja statistikore. ($P < 0,05$). Kjo pasqyrë tregon gjithashtu për izolime më të shpeshta të Klebsielave dhe të Proteus mirabilis në meshkuj sesa në femra, por ndryshimet nuk janë sinyifikative nga pikëpamja statistikore ($P > 0,05$).

Shpërndaria e shtameve sipas ngarkesës mikrobiike jepet në pas-qyrën nr. 4.

Pasqyrë Nr.4: Shpërndaria e shtameve sipas ngarkesës mikrobiike.

Numri i mikrobiave për mililitër	Shpërndaria e shtameve si numër					Shuma	%
	Escherichia coli	Klebsiella	Enterobacter	Proteus	Citrobacter		
100.000	16	2	2	4	0	24	16,7
500.000	17	1	2	4	2	29	20,1
1000.000	16	1	2	4	0	26	18,1
5.000.000	31	0	5	1	1	38	26,4
10.000.000	15	2	0	0	0	17	11,8
50.000.000	8	1	0	0	0	9	6,2
100.000.000	1	0	0	0	0	1	0,7

Kjo pasqyrë tregon se ngarkesa mikrobiike 5.10^5 - 5.10^6 mikrobe për ml. është hasur më shpesht, në 93 raste ose 64,6%. Ngarkesa mikrobiike mbi 10⁶ është vërejtur rrallë, vetëm në 10 raste (6,9%): 9 raste —

Escherichia coli dhe një rast — *Klebsiella*. Nga të dhinat e kësaj pasqyre është vështirë të zbulosh ndonjë lidhje korelativë të shprehur ndërmjet llojit të mikrobit dhe shkallës së ngarkesës mikrobiqe.

Koncentrimi minimal frenues (KMF) i streptomicinës dhe i tetraciklinës përkundrejt 144 shtameve është dhënë në pasqyrën nr. 5.

Pasqyra nr. 5: Koncentrimi minimal frenues ($\mu\text{g}/\text{ml}$) i 144 shtameve *Enterobacteriaceae* të isoluar në infisionel urinare.

	VITI SHTHAMË KONTAKT	KONCENTRIMI MINIMAL FRENUES NË MIKROBËN									
		STREPTOMICIN			TETRACIKLIN			MIKROBË			
<i>Enterobacteriaceae</i>		100	50	25	12,5	6,25	3,12	0,19	0,09	0,04	0,02
<i>Escherichia coli</i>	101	20	6	3	8	4	11	26	17	5	1
<i>Alikaklescens-dispar</i>	3										
<i>Klebsiella</i>	7	2	1								
<i>Enterobacter cloacae</i>	5	5									
—“ aerogenes	4	1	1								
—“ liquefaciens	2	1									
<i>Proteus mirabilis</i>	17	44									
—“ rettgeri	1	1									
—“ morganii	1										
<i>Citrobacter</i>	3	2									

Klasifikimi i shtameve në bazë të KMF-së, në të ndjeshëm, mesa tariشتë të ndjeshëm dhe rezistentë përkundrejt streptomicinës tetraciklinës, si dhe frekuanca e shtameve me rezistencë të dyfishtë ($S + T$) jepen në pasqyrën nr. 6.

Pasqyrat nr. 5 dhe 6 tregojnë se frekuanca e shtameve rezistentë ndaj streptomicinës dhe tetraciklinës është përkrahështë e lartë: 42 shtame (29,2%) janë rezistentë ndaj streptomicinës dhe 56 (38,9%) ndaj tetraciklinës. Megjithëse në pamjen e parë duket se frekuanca e shtameve rezistentë ndaj streptomicinës është më e ulët se ajo ndaj tetraciklinës, prapësepaprë, analiza statistikore nuk provon ndryshim me sinjifikative ndërmjet tyre ($P > 0,05$).

Nga 101 shtame *Escherichia coli*, vetëm 20 (19,8%) janë rezistentë ndaj streptomicinës dhe 33 (32,7%) ndaj tetraciklinës. Shtamet rezistentë hasen më shpesh në grupin *Klebsiella-Enterobakter* dñe në *Proteus mirabilis*. Nga 18 shtame *Klebsiella-Enterobakter*, 44,4% e tyre janë rezistentë ndaj streptomicinës dhe 50% ndaj tetraciklinës, ndërsa nga 17 shtame *Proteus mirabilis*, përgjindja e shtameve rezistentë është përkatesisht 64,7% dhe 70%. Nga grupi *Klebsiella-Enterobakter* bie në sy rezistencë shumë e lartë dhe e shpeshtë e *Enterobacter cloacae*.

Pasqyrë Nr.6: Klasifikimi i 144 shumeve në bazë të KMF-5.

SPECIES	STREPTOMYCIN		TETRACIKLEN		RESISTENCË KONDICIONALE ME RESISTENCË INDIREKTE	PERCENTAJE DE RESISTENCË DIRECTE
	MESAK INDIREKTE	MESAK KONDICIONALE	MESAK INDIREKTE	MESAK KONDICIONALE		
<i>Enterobacteriaceae</i>						
<i>Escherichia coli</i>	64(63,3%)	17(16,8%)	20(19,8%)	6(60,4%)	4(6,9%)	33(23,7%)
<i>Alkalorespirans-Diphtheriae</i>	2	1	0	2	0	1 (6,7%)
<i>Klebsiella</i>	3	2	2	4	0	3 (24,3%)
<i>Enterobacter cloacae</i>	0	0	5	1	0	4 (30%)
<i>---</i> <i>aerogenes</i>	2	2	0	1	2	1 (50%)
<i>---</i> <i>liquefaciens</i>	1	0	1	0	1	1 (50%)
<i>Proteus mirabilis</i>	6(35,3%)	0	4(64,3%)	2(61,8%)	3(47,6%)	12(70,6%)
<i>---</i> <i>rettgeri</i>	0	0	1	1	0	0 (0%)
<i>---</i> <i>morgani</i>	1	0	0	1	0	0 (0%)
<i>Citrobacter</i>	1	0	2	2	0	1 (50%)
SHUMA	80	22	42	75	13	56
	(55,5%)	(45,3%)	(40,2%)	(52,1%)	(9%)	(39,9%)
						(20,8%)

DISKUTIM

Pavarësisht nga simptomatologjia klinike, e madje elhe në mungësë të saj, zbulimi në urinë i bakterieve dhe i leukocitave polinuklearë me shumicë, flet për praninë e një infekzioni urinari. Një bakteruri e rendësishme në rrjetë të urinës se miengjosit është një tregues i vlefshëm vetëm kur urina mblidhet në një enë sterile pas pastrimit paraprak të organeve gjenitale dhe kur ekzaminimi kryhet pa vonesë.

Të shumta janë teknikat bakteriologjike që lejojnë përcaktimin e numrit mikrobiq për millilitër urine (1,8). Ato më të perpiktat kërkojnë shumë kohë dhe shpenzime materiale. Teknika e propozuar nga Gould J.C. dhe e rekomanduar nga disa autore (8) na duket një teknikë mjaft e dobishme në shumë pëlkëpamie, qoftë për përpiktorinë e saj, qoftë për lehtësinë teknike të realizmit, qoftë për vlerësimin e shpejtë të rezultateve. Kanë kaluar më shumë se 10 vjet që në përdorim me sukses këtë teknikë në ekzaminimet e përditshme dhe mendojmë se ajo mund të zhatohet lehtë në të gjithë laboratorët bakteriologjike të vendit tonë.

Në vlerësim i përafërtë i numrit mikrobik mund të bëhet edhe gjatë eksaminimit drejtpërdrejt të urinës në mikroskop: 10 bakteri për fushë kërkojnë afërsisht me 10⁵ mikrobe për mililitër.

Të shumë janë mikrobet që mund të izolohen gjatë infeksioneve urinare. Enterobakteracetë zënë vendin kryesor. Në bazë të të dhënave që disponojmë për këtë periudhë (1970-1972), Enterobakteriacetë, kokët grampozitivë (Staphylococcus pyogenus, Streptococcus beta dhe alfa hemolitikë) dhe Pseudomonas aeruginosa ndodhen afërsisht në raporte 8:1:1. Kjo gjë përpunhet edhe me të dhënat e literaturës (1,2). Shumë më rraale vegohet salmonelat, *Mycobacterium tuberculosis* dhe kërpudhat e gjinisë *Copadida*.

Nga Enterobakteriacetë, *Escherichia coli* luan rolin kryesor në infeksionet urinare (1,2). Këtë gjë provon dhe ky studimi ynë: 70,1% e shtrameve të veguar ishin të tillë. Duke u bazuar në strukturën antigenike (antigjene O, H dhe K) janë përshtuar më shumë se një mijë serotipa të ndryshëm të *Escherichia coli*. Kjo mori serotipash peragon padyshim identifikimin serologjik të tyre. Në mungesë të identifikimit serologjik, dallimi ndërmjet reinfeksioneve dhe recidivate është i pamundur.

Proteus mirabilis renditet i dyti sipas frekuencës (11,8%). Roli i gjinive të tjera të *Proteus*it në infeksionet urinare spontane, që harrëtigeri u veguan vetëm në 1,4% të rasteve. Megjithatë njihet mirë dhe është i rëndësishëm roli i *Proteus*it në formimin e gurëve (urolitiazës).

Më rrallë u izoluan shtame të gjinisë Enterobacter (7,6%) dhe *Klebsiella* (4,9%). Duhet theksuar se pejsazhi mikrobik ndryshon në të sëmurët që i nënshtronen ndërhyrjes urologjike. *Pseudomonas aeruginosa*, në veçanti, është gjithmonë përfaqësues i infeksioneve sekondare të shkaktuara nga këto ndërhyrje.

Në literaturë ka të dhëna, megjithëse të pakta, që flasin për ndryshimin e strukturës etiologjike në varësi me moshën dhe seksin. Disaj autorë (2) kanë veguar *Proteus*in më shpesht në gjemini sesa në vajtona, ndërsa *Klebsiellat* më shpesht në të sëmurë mbi 55 vjec. Të dhënat (76,6%) në krahasim me meshkujt (58%) Diferanca ndërmjet këtyre treguesve është e rëndësishme nga ana statistikore ($P < 0,05$). Të dhënat tona tregojnë gjithashtu izolime më të shpeshta të *Klebsielave* dhe të *Proteus mirabilis* në meshkujt sesa në femra, por ndryshimet janë sinjifikative nga ana statistikore ($P > 0,05$). Shtamet tona janë veguar më të rritur, por ne nuk kemi të dhëna mbi moshën e tyre, prandaj nuk mund të paraqesim ndryshime në raport me moshën.

Pavarësisht nga mosha, frekuanca e infeksioneve urinare është më e lartë në femrat sesa në meshkujt. Gjatësia e uretrës dhe një faktor baktericid i origjinës prostatike janë faktorët kryesore që pengojnë infeksionet ashendente në meshkujt. Sipas disa autorëve (2), raportet e infeksioneve ndërmjet meshkujve dhe femrave lëkunden me moshën dhe janë: deri në 15 vjeç 1/3,5; 16 deri 35 vjeç – 1/17,5 dhe mbi 35 vjeç – 1/1,9. Në bazë të të dhënave tona, ky raport është 1/1,9 (50/94).

Për një terapi antinfekcioze sa më efikase, antibiograma është

e nevoishme në qdo rast infekzioni urinar. Ajo është e domosdoshme sidomos gjatë izolimit të mikrobeve që merren në mjedisin spitalor, të cilët dallohen për rezistencën e tyre të lartë e multiple.

Streptomicina dhe tetraciklina janë dy antibioticë të preferuar përmjekimini e infeksioneve urinare, qoftë për spektrin e gjierë të vepurit të tyre, qoftë për përqëndrimet e larta aktive që ata arrinë në urinë. Gjatë mjejkimeve në doza të zakonshme (1 gr. në ditë streptomicinë intramuskular dhe 1,5-2 gr. në ditë tetraciklinë per os) nivelet mesatare të arriutura përmillilitër urine janë: 300-500 mcg/ streptomicinë dhe 100-150 mcg tetraciklinë (1).

Për të përcaktuar më me siguri frekuencën e shtameve rezistente ndaj streptomicinës, ne përdorim teknikën e hollimeve në agar. Kjo teknikë është e ndërikuar, kërkon shumë kohë dhe miete, prandaj nuk mund të zbatohet gjatë ekzaminimeve të përditshme. Megjithatë, kjo teknikë është e domosdoshme në të gjitha rastet e infeksioneve të zgjatura e të përsëritura, që i nënshtronen mjejkimit me vështirësi.

Streptomicina dhe tetraciklina kanë qenë shumë të dobishëm përrajtimin e infeksioneve urinare të shkaktuara nga Enterobakteriacetë, por dobia e tyre sot për sot është zvogëluar nga rritja e numrit të shtameve rezistente (10). Edhe ky studim i ynë vërtetton se shtamet rezistente ndaj streptomicinës (29,2%) dhe tetraciklinës (38,9%) janë përkrahësish të shpeshtë. Përkrahësish shpesh hasen gjithashu shtamet me rezistencë të dyfishtë (20,8%). Kjo frekuencë e shtameve rezistente e detyron urologun të përdorë antibiotikët e lartpërmëndur jo me hamendje, por vetëm në ato raste kur antibiograma tregon se shtami i veçuar është i ndjeshëm ndaj tyre.

Lista e antibiotikëve dhe e preparateve sulfamidikë, që sot përdoren me sukses më trajimin e infeksioneve urinare, është e gjiere, vetëm duhet që zgjedhja të jetë e drejtë, në përputhje me të dhënat e një antibiograme të bërë me kujdes.

PERFUNDIME

1) *Escherichia coli* është përfaqësuesi i familjes së Enterobakteriaceve që vegohet më shpesh gjatë infeksioneve urinare tek të rriturit, në 144 shtame të izoluar, 101 (70,1%) qenë *Escherichia coli*. Pro-tus mirabilis renditet i dyti sipas frekuencës (11,8%), ndërsa pjesëtarët e gjinive të tjera hasen përkrahësish rrallë.

2) *Escherichia coli* vegohet më shpesh në femrat (76,6%) sesa në meshkujt (58%) dhe ndryshimi është i rëndësishëm nga ana statistikore ($P < 0,05$); *Klebsiella* dhe *Proteus mirabilis*, përkundrazi, u vëguan më shpesh në meshkujt sesa në femrat, por ndryshimet nuk janë të rëndësishme ($P > 0,05$).

3) Nuk zhulenet ndonjë lidhje korelativë e shprehur ndërmjet illo-jit të mikrobit dhe shkallës së ngarkesës mikrobiike. Ngarkesa mikrobiike 5.10⁵-5.10⁶ është hasur në pjesën më të madhe të rasteve (64,6%).

4) Shtamet rezistente ndaj streptomicinës (29,2%) dhe tetraciklinës (38,9%) u vëguan përkrahësish shpesh. Një frekuencë përkrahë-

sistit të lartë patën edhe shtamet me rezistencë të dyfishtë (20,8%). Përqindjet më të larta të shtameve rezistente u varetjan tek *Proteus mirabilis* dhe në grupin e *Klebsiella-Enterobacter*.

Dorëzuar në Redaksi më 10 korrik 1979.

B I B L I O G R A F I A

- 1) Acer J. F. et coll.: Infection urinaire de l'adulte. Rev. Prat. (Paris), 1974, T. XXIV, 19, 1669-1697, 1701-1705, 1771-1781.
- 2) Crump J. and coll.: Urinary infection in general practice. The Lancet 1976, I (1970) 1384.
- 3) Duraku E.: Vecoritë biokimike të 616 shtameve shigella. Buletini i UT- Seria Shkencat mjekësore 1974, 2, 73.
- 4) Duraku E.: Resistenza e shigelave ndaj antibiotikave Kloramfenicol, tetracikline dhe streptomycine. Buletini i UT- Seria shkencat mjekësore 1975, 2, 73.
- 5) Edwards P.R., Ewing W.H.: Identification of Enterobacteriaceae 2 nd. ed. Minneapolis, Minnesota 1982.
- 6) Kauffmann F.: Enterobacteriaceae. E. Munksgaard, Copenhagen 1954.
- 7) Le Minor L.: Le diagnostic de laboratoire des Enterobactéries 3. ed Editions de 1960.
- 8) Piel A. Ja. e bp.: Sjavnitelnaia ocenka novih metodov opredelenija stopeni bakteriurii v diagnostike hronikeskoj pielonefriti. Sovjetskaja Medicina 1966, 10, 3.
- 9) Varese L. A. e bp.: La batteriologia nelle infezioni delle urinarie dell'infanzia. Minerva pediatrica 1975, 27, 32, 1761.
- 10) Weinstein Louis: Antibacterial Agents: Streptomycin, Gentamycin and others (Aminoglycosides (1167-1172) the Tetracyclines and Chloramphenicol (1183-1194), ne: The pharmacological Basis of Therapeutics Ed. L.S. Goodman and A. Gilman fifth edition New York 1975.

S u m m a r y

ENTEROBACTERIA ISOLATED IN URINARY INFECTIONS AND THEIR SENSITIVITY TO STREPTOMYCIN AND TETRACYCLINE

The frequency of various genera of the Enterobacteriaceae family associated with urinary infections of adults was determined after a careful study of 144 strains isolated from such patients. Their sensitivity was also studied to streptomycin and tetracycline on the basis of the lowest inhibiting concentration.

The genera identified were: *Escherichia* (including *Alkalotolerans Dispar*) 72.2%, *Klebsiella* 4.9%, *Enterobacter* (*cloacae*, *aerogenes* and *liquefaciens*) 7.6%, *Proteus mirabilis* 11.8%, *Proteus morganii* 0.7%, *Proteus rettgeri* 0.7%, *Citrobacter* 2.1%.

Escherichia coli was found more frequently in women (76.6%) than in men (58%), the difference being statistically significant ($P < 0.05$). On the contrary, *Klebsiella* and *Proteus mirabilis* were more frequent among men than among women, but the difference was not significant ($P > 0.05$).

Strains resistant to streptomycin or tetracycline were comparatively frequent, 29.2 and 38.9% respectively. Strains with double resistance (to both streptomycin and tetracycline) were also relatively frequent (20.8%).

The highest proportion of resistant strains was found in the *Proteus mirabilis* and the *Klebsiella-Enterobacter* group.

Résumé**ENTEROBACTERIES IDENTIFIÉES DANS LES INFECTIONS URINAIRES ET LEUR SENSIBILITÉ À L'ÉGARD DE LA STREPTOMYCINE ET DE LA TETRACYCLINE**

Se fondant sur identification minutieuse de 144 souches, l'auteur du présent article détermine la fréquence des différentes espèces de la famille des Enterobacteraceae dans les infections urinaires chez des adultes. Il a déterminé aussi, sur la base de la concentration minimale inhibitrice, leur sensibilité à l'égard des antibiotiques que sont streptomycine et la tetracycline.

Les différentes espèces de la famille des Enterobacteriaceae ont été isolées selon la fréquence suivante: *Escherichia coli* (y compris *Alcalascens-Dispar*) 72,2%; *Klebsiella* 4,9%; *Enterobacter* (cloacae, aerogenes et liquefaciens) 7,6%; *Proteus mirabilis* 11,8%; *Proteus morganii* 0,7%; *Proteus rettgeri* 0,7% et *Citrobacter* 2,1%.

Escherichia a été isolée surtout chez les femmes (76,8%) et dans une moindre mesure chez les hommes (58%), cette différence étant importante du point de vue des statistiques ($P < 0,05$); *Klebsiella* et *Proteus mirabilis*, par contre, a été isolée plus fréquemment chez les hommes par rapport aux femmes, mais les différences relevées ne sont pas importantes ($P > 0,05$).

Les souches résistantes à l'égard de la streptomycine et de la tetracycline étaient relativement fréquentes, respectivement dans l'ordre de 29,2 et 38,9% des cas. Une fréquence relativement élevée (20,3%) caractérise aussi les souches à double résistance (S + T).

Les souches présentant un taux plus élevé de résistance concernent l'espèce *Proteus mirabilis* et le groupe *Klebsiella-Enterobacter*.

STOMATOLOGJI

DISA KONSIDERATA MBI PROCESET INFLAMATORE AKUTE TE REGJIONIT MAKSILO-FACIAL PER PERIODHEN 1973-1976

— [Doc. DHORI POJANI —

(Katedra e Kirurgjisë Stomatologjike)

Me masat e marrura nga Partia dhe Qeveria si shtimi i kuadrit stomatologjik, shtrirja e ndilimës stomatologjike në qytet e në fshat, mjekimi falas etj., proceset inflamatore akute të regjionit maksilo-facial janë pakësuar në mënyrë të ndjeshme. Por meqithatë ato takohen ende shpesh në praktikën tonë stomatologjike dhë zenë një nga vendet e para në sëmundjet kirurgjikale stomatologjike. Për këtë dëshnon fakti se gjatë viteve 1973-1976 nga 962 të sëmurë me sëmundje stomatologjike, 324 (34%) ishin me infekstone akute (abcese e flegmone dhe osteomielite) ose në raport 3 : 1, d.m.th. nga 4 të shtruar, një ishte me proces inflamator. Këtë raport e jep edhe autorë të tjera (2,8).

Shpeshësina e martë (34%) me procese inflamatore të njekur në spital e shpjegojmë me faktin se përvëç rasteve të rënda, që vijnë nga qyteti, një pjesë e tyre vinë edhe nga rrëthet fqinje dne sidomos nga fshati.

Të 324 të sëmurët me procese inflamatore, për të cilët bëjmë fjalë në këtë studim, ditëqindrimi i përgjithshëm në spital ka qenë 2550, mesatarisht rrëth 8 ditë për çdo të sëmure.

Në këtë studim do të nxjerrim disa tregues kryesorë për këtë patologji të shpeshtë, si vëllimin e punës që ato zënë, shpeshësinë e tyre lidhur me moshën, seksin, lokalizimin topografik, llojet, faktorët etiologjikë, mënyrën e trajtimit etj.

Nga 324 të sëmurë që jemi duke marrë në studim, 57% ishin meshkuj dhe 43% femra. Kjo përpunhet me të dhënat e autorëve të ndryshëm (2, 7, 11). Si shumë autorë edhe ne këtë fakt e shpjegojmë me kujdesin e pamjafueshmë që tregojnë meshkujt përgojën dhe dhëmbët.

Lidhur me etiologjinë, rezulton se 60% janë me origjinë odontotogene ose në raport 3 : 2. Kjo e dhëne është më e ulët se ajo që jepet në studimin e kryer më 1973 (11) në kushte ambulatorë, ku kemi gjitur 67% me origjinë nga dhëmbët. Gjithashtu kjo shifër është më e ulët se ajo që jepin autorë të tjera (84% - 2, 52% - 9, 74.3% cituar nga 2).

Lidhur me moshën vjenë re se ato zhvillohen në të gjitha moshat, por më shpesh ne ato i gjemjë në grup-moshat 0-15 dhe 16-45 vjeç, që përkatesisht zënë rrëth 60% dhe 34%. Këto shifra përpunhen me studimet e kryera më parë (7, 11).

Eshë për të vënë në dukje fakti se nga mosha 6-15 vjeç; me gjithëse kemi një kontigjent më te paket të sëmuresh në krahasim me moshat 16-45 vjeç, përqindja e të sëmureve të moshës 16-45 vjeç

TE DHENA MBI DISA PROÇESE INFLAKUJE TE MUEKUAR

PER PERIUDHEN 1973-1976

Nr. i përgj. i të sëmur.	Nr. i të sëmureve me proç. INFL.	SEKSI		VENDI	ORGAN	FREKUENCA SIPAS MOSHAVE	LLOJI INFLAM	MUEKUMI	DITË TË ONDRIAMI																	
		M	F	Q	F	ODONTOGJ.	JO ODONTO	0-5 ✓	6-10 ✓	11-15 ✓	16-25 ✓	26-35 ✓	36-45 ✓	46-55 ✓	mbi 56 ✓	ADCES FLEG.	OSTEOM.	KIRURGU	KONSERV	TOTAL	MESAT.					
962	324	57	43	183	141	MF	Q	185	139	194	130	87	66	38	56	36	20	12	9	281	43	87	13	87	13	13
33,6		57	43																							

është më e pakët në krahasim me moshën 0-15 vjeç. Kjo shpiegohet me shpeshtësi e intensitetin e lartë të karësit në këto mosha (4, 5, 7, 11). Kjo vjen më shumë isidomos për grup-moshat 16-45 vjeç, sepse për grup-moshat 0-15 vjeç, përvet faktorëve etiologjikë odontogjene, në zhvillimin e abceseve, flegmoneve dhe osteomieliteve, njeri të rendësishem luajnë edhe faktorët joodontogjene.

Sipas materialit që paragjim në këtë studim vjenë re se në grup-moshat 0-15 vjeç nga 191 të sëmuret me procese inflamatore akute, 90 prej tyre (47%) janë më origjinë joodontogjene, pothuaj gjysma e tyre.

Kurse për grup-moshat 16-45 vjeç ndodh e kuandërtat: nga 112 të sëmuri, vetëm 24 ose 22% kanë qenë më origjinë joodontogjene dhe 78% kanë qenë më origjinë nga dhëmbët. Nga kjo nxjerrin përfundimin se në grup-moshat 0-15 vjeç një rol vendimtar lozin edhe faktorët joodontogjene, fahomene që nuk vihen re në grup-moshat 16-45 vjeç.

Gjithashtu është për të vënë në dukje se nga 87 të sëmure më procese inflamatore akute në moshën 0-5 vjeç, 60 prej tyre (68%) kanë qenë më origjinë joodontogjene. Nje gjë të tillë e kanë vënë re edhe autorë të tjere (9), që 74,3% të adenoflegmoneve kanë qenë më origjinë joodontogjene. Kjo shpiegohet me faktin se ky grup-mosha është tepër i predispozuar të preket nga disa sëmundje infektive, tonsilitet, otitet etj, të cilët shërbjnë si bazë për zhvillimin e abceseve, flegmoneve dhe osteomieliteve në regionin maksilo-facial.

Përsa i përket ilot të procesit inflamator vjenë re se masën kryesore të tyre e zënë abceset e flëgmonët e illozhave me 281 të sëmuret ose 87% dhe 43 (13%) me osteomielite, ose në raport 7:1. Sipas disa autorëve (cituar nga 2) abceset e flëgmonët përbëjnë 52,2% të protësive inflamatore akute që janë në raport 1:1. Kjo tregon se osbedhjeti i "hofflave" si një isëmundje e rendë e tyre, takohet rrallë në praktikë kën tonë stomatologjike. Kjo vjen si pasojë e "masave të rhenjëshësime

që mernen dhe indiqtores së kualifikuar që jepet në injektimin e shkarkesit dhe periodontiteve akute e kronike etj.

Përsë i përket lokaletizimit të abceseve dhe flegmoneve parakujten si më poshtë:

- 1) në llozhën submandibulare
- 2) në regionin infraorbital
- 3) në regionin bukal
- 4) në regionin submental
- 5) në regionin paratiramasatik
- 6) në regionin datero cervikal
- 7) në llozhën pterigomandibulare
- 8) perimandibular
- 9) ne gjuhë dhe dyshemenë e gojës
- 10) në llozhët e tjera

Infeksionet më të shpeshta i gjejmë në llozhën submandibulare me 130 raste (46%). Kjo përkon edhe me studime të tjera (3, 5, 6, 11 etj.).

Kjo shpeshtësi e lartë në këtë llozhë shpjegohet me shpashësinë tjerë (3, 4, 5,), me vështirësitë që hasen në mjekimin e ndërkimeve të tyre në këta dhëmbë, ndërkimet që jep molari i tretë, infeksionet dhe gjendhat limfatike dhe të pëshyrmës në këtë llozhë, kushtet e përshtatshme që gjën imfekzioni këtu etj. Rreth gjysma e të sëmurave të moshave 0-10 vjeç, në këtë llozhë, infekzioni ka qenë me origjinë joodontogjene.

Lidhur me mjekimin e proceseve inflamatore akute në regionin maksilo-facial, me gjithë sukseset e arritura më këtë dreitim në vendin tonë, është e nevojshme të bëhet një studim më i thelluar. Trajtimin e tyre, klinika jone e bën sipas fazës së procesit inflamator. Në format purulente bëjmë ndërhyrjen kirurgjikale, kurse në format serozë bëjmë mjekim konservativ me antibiotikë dhe mjekime të tjera me osa bëpa heqje të dhëmbit shkakta.

Sic shihet nga pasqyra, në 282 të sëmure (87%) është përdorur mjekim kirurgjikal dhe në 42 (13%) është përdorur mjekim konservativ, tek të cilët janë bërë edhe 42 ekstraksione dhëmbash.

Ahozet, flegmonet dhe osteomieliitet, ashtu si shumë autore të tjera (9, 13), duke i konsideruar urgjencia të kirurgjisë stomatologjike, janë shtruar qysh në ditët e para të paraqites së tyre në klinikë dhe lu është bërë ndërhyrja menjëherë kur kemi pasur të bëjmë me formaipurulente. Për format serozë është filluar mjekimi konservativ intensiv me antibiotikë dhe kur dy-tre ditë e para ky mjekim nuk ka dhënë rezultatet e dëshiruar, është përdorur mjekimi kirurgjikal. Mjekimi kirurgjikal është shoqëruar edhe me mjekim konservativ me antibiotikë (penicilinë + streptomisinë etj.) Për të pasur rezultate të mira me efekt të plotë me antibiotikë pas ndërhyrjes, në 37% të tyre kemi bërë antibiogramë.

Shtimi i spital i të sëmureve ka bërë që ata të mjekohen e të ndiqen më mirë, të shërohen më shpejt dhe të mënjanohen ndërkimet që mund të ndodhin. Kjo ka bërë që të ulet paftissia e përkohshme në punë në këta të sëmureve dhe ditëgjëndrimi në spital, sippas materialit to-

Nga 103 të sëmürët, tek të cilët është bërë antibiograma, në 35 (34%) prej tyre nuk janë gjetur mikrobe patogjene (negativ), kurse në 68 raste (66%) është përcaktuar antibiotiku që vepron dhe shkalla e veprimit të tij. Në 22 të sëmürë është përcaktuar dhe lloji i mikrobit. Nga 22 rastet, në 16 (73%) prej tyre është gjetur infekzioni stafilocksik, kryesisht aureus. Kjo e dhënë përputhet me të autorëve të tjere (2, 3, 12). Gjithashtu kjo tregon se në infeksionet akute të regjionit maksilo-facial mbizotëron infekzioni stafilocksik, ashtu si në infeksionet tonsilare (12).

Nga të dhënat e antibiogramës vërejtëm se në 35 (51%) të sëmürë vepronin antibiotikët e serisë së II, në 6 të sëmürë (9%) të serisë së I dhe në 4 të sëmürë vepronin të serisë së I e II. Vien të theksojmë se në shumicën e rasteve me antibiogramë negativ ose tek ato pozitivë por që nuk veprojnë antibiotikët e serisë së I, janë trajtuar më parë, ose kur janë paraqitur tek ne, me antibiotikët e zakonishtëm (penicilinë, streptomycinë ose tetracklinë). Kjo ka bërë që mikrobi të mos zhvillohet dhe të ketë fituar rezistencë ndaj antibiotikëve të serisë së I.

PER FUNDI ME

1) Abceset, flegmonet, dhe osteomielitet e regjionit maksilofacial takohen shpesh në praktikën stomatologjike ambulatorore dhe spitalore. Sipas materialit tonë ato përbëjnë 34% të të sëmürëve të shtruar ose 3:1, kurse në fshat, sipas materialit tonë, këto infeksione takohen në 43%.

2) Në zhvillimin e proceseve inflamatorore akute, një vend të rendësishëm zenë ato me origjinë odontogjene (rrëth. 60%).

3) Proseset inflamatorore akute zhvillohen më shpesh në moshat 0-15 vjeç — 60% e rasteve tonë; rrëth dyfishi i të sëmürëve të moshave 16-45 vjeç. Kjo shpeshtësi e lartë vjen si posojë e zhvillimit në këto grup-imosha të formave me etiologji joodontogjene, të cilat përbëjnë 47% të rasteve tonë dhe kryesisht në fëmijë të moshës 0-5 vjeç.

4) Midis proceseve inflamatorore, më shpesh takohen abceset dhe flegmonet e llozhave dhe më rrallë osteomieliteti në raport 7:1 dhe midis tyre, vendin kryesor e zenë ato të llozhës submandibulare me 130 raste (46%).

5) Mjekimi i abceseve, flegmoneve duhet të kryhet sa më herët e në mënyrë të kualifikuar. Në format purulenje duhet të bëhet ndërhyrja kirurgjikale, ndërsa në format serozë duhet të kryhet mjekimi konzervativ me antibiotikë. Sipas materialit tonë, në 87% është përdorur incizioni dhe në 13% mjekimi konzervativ. Pas incisionit në format e rënda, mjekimi me antibiotikë duhet të bëhet mbi bazën e antibiogramës.

Dorëzuar në redaksi më 15 janar 1979

B I B L I O G R A F I A

- 1) Andoni R., Piaka Dh.: Konsiderata bakteriologjike mbi stafilokokun e izoluar në proceset inflamatore supurative. Shärdetësia popullore 1975, 3.
- 2) Bernadski J.: Osnovi kirurgiceskoi stomatologii. Kiev 1970, 148.
- 3) Devetakov M. e bp.: Verhu antibiotikoterapija na vespalielnit procesi na lico - celostna oblast. Stomatologija. Sofia 1973, 3, 210.
- 4) Dibra J.: Diska të dhëna klinikë lidhur me kohën e prekjes nga karieri të morarit të parë të përhershëm. Punime stomatologjike. Tiranë 1977, 1, 40.
- 5) Ivanov S. e bp.: Njakuaj osobnosti na abceset e liegnonte v deutska vezast. Stomatologija. Sofia 1973, 3, 184.
- 6) Kasapi I.: Mbi shpeshtësinë e depistikshmë faktorëve etiologjikë në proceset inflamatore akute odontogjene në regionin maksilo-facial. Punime stomatologjike. Tiranë 1978, 2, 39.
- 7) Lukjanenko V.: K vaproso o legenie ostriti vospalitelnih zabolovanj jazika. Stomatologija. Moskva 1955, 5, 62.
- 8) Molqanova K. e bp.: Nekotore oslozhnenie odontogenih zabolovanje qejosnost - liecevoj oblast. Stomatologija. Moskva 1972, 2, 45.
- 9) Novoselov R. e bp.: Odontogenie vospalitelni zabolovanie u detij. Stomatologija. Moskva 1971, 3, 55.
- 10) Piaka Dh. e bp.: Të dhëna mbi ndjesmërinë ndaj antibiotikëve të stafilokokëve të izoluar nga proceset qelbëuese gjatë viteve 1965-1975. Buletini i UT - Serbia shkencore 1973, 2, 65.
- 11) Pojani Dh., Kasapi I.: Të dhëna klinikko-statistikore mbi proceset inflamatore të regjionit maksilo-facial dhe trajtimi i tyre. Buletini i UT - Serbia shkencore 1973, 2, 115.
- 12) Pojani Dh.; Koci Th.: Mbi përdorimin e antibiotikëve në sëmundjet inflamatore të regjionit maksilo-facial. Buletini Stomatologjik 1975, 2, 68.
- 13) Ulqinaku F.: Proseset inflamatore të regjionit maksilo-facial. Buletini Stomatologjik 1977, 2, 24.

S u m m a r y

CONSIDERATIONS ON THE ACUTE INFLAMMATORY PROCESSES OF THE MAXILLO-FACIAL REGION OBSERVED DURING THE PERIOD 1973-1976

An analysis is presented of 324 cases of acute inflammatory processes of the maxillo-facial region admitted to hospital during the period 1973-1976, from which some useful indices were derived concerning the length of stay in hospital, the age, the etiology, the location and the methods of treatment of these processes.

The analysis shows that 60% of the processes are odontogenic; 57 of them were in male subjects. They were more frequent in the age group of 0-15 years (60%), and of these 47% were of non odontogenic origin. The most frequent forms of infections were abscesses and phlegmons (87%).

As regards the location, the submandibular phlegmons constituted 46% of the cases.

In 262 cases, or 87%, surgical treatment was applied with or without a subsequent antibiotic treatment. The average length of stay in hospital was 7.9 days.

CONSIDÉRATIONS SUR LES PROCESSUS INFLAMMATOIRES AIGUS DE LA RÉGION MAXILLO-FACIALE PENDANT LES ANNÉES 1973-1976

PAR J. POJANI, M. DORL ET J. L. BONNET

DU DEPARTEMENT D'ORTHOPÉDIE DE LA CHIRURGIE MAXILLO-FACIALE
DU HÔPITAL UNIVERSITAIRE DE LYON

Résumé

Pendant la période 1973-1976, l'auteur de la présente communication a analysé 324 malades souffrant de processus inflammatoires aigus de la région maxillo-faciale et qui ont été traités dans des hôpitaux. C'est ainsi qu'il a pu établir certains indices très importants comme la durée de séjour des malades à l'hôpital, leur âge, les facteurs étiologiques, la localisation topographique du mal et le mode de son traitement.

Des matériaux recueillis il ressort que dans 60% des cas le mal est d'origine odontogène, dont 57% sont des hommes. Ces processus se développent surtout de 0 à 15 ans (60%) dont 47% sont d'origine non odontogène. Les infections les plus fréquentes constatées sont l'abcès des phlegmons (87%).

Quant à la localisation des infections, les phlegmons submandibulaires en constituent 46%.

Dans 282 cas soit 87%, on a eu recours à l'intervention chirurgicale, accompagnée ou non d'un traitement conservatif avec des antibiotiques. La durée moyenne de séjour des malades à l'hôpital est de 7,9 jours.

Keywords: Inflammation - Odontogenic infection - Phlegmon - Hospitalization - Surgery.

Résumé Pendant la période 1973-1976, l'auteur de la présente communication a analysé 324 malades souffrant de processus inflammatoires aigus de la région maxillo-faciale et qui ont été traités dans des hôpitaux. C'est ainsi qu'il a pu établir certains indices très importants comme la durée de séjour des malades à l'hôpital, leur âge, les facteurs étiologiques, la localisation topographique du mal et le mode de son traitement.

Des matériaux recueillis il ressort que dans 60% des cas le mal est d'origine odontogène, dont 57% sont des hommes. Ces processus se développent surtout de 0 à 15 ans (60%) dont 47% sont d'origine non odontogène. Les infections les plus fréquentes constatées sont l'abcès des phlegmons (87%).

Quant à la localisation des infections, les phlegmons submandibulaires en constituent 46%.

Dans 282 cas soit 87%, on a eu recours à l'intervention chirurgicale, accompagnée ou non d'un traitement conservatif avec des antibiotiques. La durée moyenne de séjour des malades à l'hôpital est de 7,9 jours.

Mots-clés: Inflammation - Infection odontogénique - Phlegmon - hospitalisation - chirurgie.

Le présent article présente une étude sur les processus inflammatoires aigus de la région maxillo-faciale. Il s'agit d'une analyse de 324 malades traités dans des hôpitaux de Lyon entre 1973 et 1976. Les auteurs ont cherché à déterminer les facteurs étiologiques, la localisation topographique, la durée de séjour à l'hôpital et le mode de traitement.

Il ressort de l'étude que 60% des malades sont atteints d'infections d'origine odontogénique, dont 57% sont des hommes. Ces processus se développent surtout chez les enfants de moins de 15 ans (60%) dont 47% sont d'origine non odontogène. Les infections les plus fréquentes sont l'abcès des phlegmons (87%).

Quant à la localisation des infections, les phlegmons submandibulaires en constituent 46%.

Dans 282 cas soit 87%, on a eu recours à l'intervention chirurgicale, accompagnée ou non d'un traitement conservatif avec des antibiotiques. La durée moyenne de séjour des malades à l'hôpital est de 7,9 jours.

PËRHPAJA E ANOMALIVE TË DHËMBËVE TEK FEMIJËT E QYTETIT TE TIRANËS

- AFERDITA BASHA — DHIMITRA LIRA — FOTO TOTI — OSMAN HOXHA —
— BUDI SINAS — HAJRULLA MUÇA —

(Katedra e Ortopedisë Stomatologjike)

Shumëlljoshmëria e faktorëve dhe mekanizmave etiopatogenetike të anomalive, e lidhur ngushtë me vgoricë individuale dhe një sërë faktorësh kollateralë, janë shkaku kryesor i një shumëlljoshmëri të thesuar klinike, që karakterizon anomalitë e sistemit dhëmbë, nofulla, e fytyrë (8, 9). Jo vetëm në dy pjesë të ndryshëm, por edhe tek i njëjtë njeri, në të njëjtën kohë ose në fazë të ndryshme, mund të veprojnë shume faktore etiologjike, veprimi i të cilëve do të varet nga intensiteti dhe koha në të cilën ka vepruar ngacmuesi.

Nuk janë të rralla rastet kur përfshi anomali mund të mendohet vetëm një shkak. Por edhe më të shpeshtë janë ato kur faktore të ndryshëv varen nga njëri tjeteri dhe bashkëveprojnë midis tyre.

Studimi i aspektave epidemiologjike të anomalive të sistemit dhëmbë, nofulla, fytyre ka qenë objekti i shumë projekteve dhe studimeve të autorëve në vende dhe kohë të ndryshme. Megjithatë edhe pse me dëshira dhe qëlime të njëjta, të dhënat e tyre, përsye subjektive dhei, deri, dikur objektive, nuk rezultojnë të njëjta, ndoshta nuk do të gabonim po të thonim edhe në kundërshtim njëra me tjetën. Kjo sepse, në ndjekjen e problemeve nuk ka pasur një metodë të vetme nga të gjithë autorët dhe vlerësimi i shuangjeve nga norma është bërë më shumë mbi kritere subjektive nga ana e tyre.

Kështu, sipas disa autorëve, anomalitë e dhëmbëve janë takuar në 23% të fëmijëve, në 36%, në 43.2%, në 50% (cituar nga 8) dhe një tjetër në 32.5% (7).

Studimi ynë mbështetet në kontrollin stomatologjik të 5724 fëmijëve të moshave 3-18 vjeç. Në këtë studim do të përcaktojmë përhapjen e anomalive të dhëmbëve tek fëmijët dhe dendësinë e tyre në vartësi nga seksi dhe mosha. Gjithashtu do të përcaktojmë përhapjen e detajuar të llojeve të veganta të këtyre anomalive tek fëmijët.

R e z u l t a t e t . — Nga 5724 kontrollë stomatologjike, ndër të cilët 2910 ishin femra dhe 2814 ishin meshkuj, në 1627 prej tyre (28.46%) undeshën anomali të ndryshme në dhëmbë. Natyrish, anomalitë e dhëmbëve nuk indeshen gjithmonë të vecuara. Shumë autorë venë në dukje se anomalitë e dhëmbëve gëshshëtohen qoftë ndërmjet tyre, qoftë me anomalitë e vetë nofullave (4, 7). Edhe në kontrollot tona kemi vërejtur një gjë të tillë. Në këto raste, anomali kryesore në kemi vlerësuar ato që klinikisht kanë mbizotëruar më shumë. Të dhënat mbi përhapjen e anomalive të dhëmbëve në përgjithësi parashiten në pasqyren (H. 1).

Pasqyra nr. 1

Përhapja e anomalive në përgjithësi

Nr. i fëmijëve	Nr. i atyre me anomali	Me anomali noshkash	Me anomali dhëmbesh
5724	3878(67.79%)	2251(39.33%)	1627(28.46%)

Nga studimi ynë del se anomalitë e dhëmbëve u ndeshën me një shpeshtësi prej 30.9% në femra dhe 25.9% në meshkuj. Përsa u takon grup-moshave, ato vërehen më shpesht në 7-12 vjeç dle 13-18 vjeç. Pranë periodhat e kafshimit të përzjere dle të përhershëm. Kjo ndoshta lidhet me faktoret e ndryshëm që veprojnë në periudhën e ndrimt fizioligik të dhëmbëve të përkohshëm dle zëvendësimin e tyre me ata të përhershëm, pra me qëndrimin e tyre më vonë në harkun e dhëmbëve të përhershëm, gjatë lëvizjeve të ndryshme fiziologjike të tyre, gjatë ndrimt etj. Kështu në grup-moshën 7-12 vjeç etj., anomalitë e dhëmbëve ne i takuan në 30.40% të fëmijëve, ndërsa në atë të 13-18 vjeç në 31.40% të tyre. Shumë më rrallë ato i takuan në periudhën e kafshimit të përkohshëm (grup-mosha 3-6 vjeç në 5.40% të fëmijëve). Spas një autorë (⁷) ato janë takuar në të tre këto sisteme në shifrat 17.1%, 17.9% dhe 18.9%.

Përhapjen e anomalive të dhëmbëve në varësi të seksit dle grup-moshës po i paraqesim në pasqyrën nr. 2.

Pasqyra nr. 2

Grup-mosha	Femra			Meshkuj		
	Fëmijë të vizituar	Me anomalie dhëmbesh	Të vizituar	Me anomalie	Të vizituar	Me anomalie
3-6 vjeç	559	30(5.40%)	240	93(7%)	319	21(6.8%)
7-12 vjeç	2529	(30.40%)	1191	392 (32.0%)	1338 (28.2%)	377
13-18 vjeç	2636	(31.40%)	828	1479 (33.7%)	499 (32.9%)	1157 (28.4%)
3-18 vjeç	5724	(28.40%)	1627	2910 (30.9%)	900	2814 (25.9%)

Në përeaktimin e llojeve të vëganta të anomalive të dhëmbëve, si pas materialit tonë, vendin e parë e zënë anomalitë e pozicionit të dhëmbëve, ashtu si tregohet në pasqyrën nr. 3.

Pasqyra nr. 3

Përhapia e anomalive të dhëmbëve sipas illojeve të vepçanta të anomalive

Fëmijë të vizituar	Me anomali dhëmbësh	Me anomali pozicioni	Me anomali kontakti Diastema	Me anomali strukture	Me anomali nr.	Me anomali madh. form. më
5724	(28.46%)	1627 (17.7%)	1016 (6.2%)	355 (1.8%)	105 (1.7%)	50 (0.8%)

Sipas disa autorëve (6, 7, 8) vendin e parë e zë rotacioni në 35.9% të dytin diastema në 16.5% dhe të tretin vendosja palatinale (qiellzore) e dhëmbëve në 13.5% të të gjithë anomalive të dhëmbëve.

I). *Anomalitë e pozicionit të dhëmbëve.* — Këto janë anomali më të shpeshta nga të gjitha anomalitë e dhëmbëve që u takuan nga ne dhe pikërisht në 17.7% të fëmijëve. Dendësia e lartë e kësaj anomalie, siç duket, është e lidhur me reduktimin filogenetik të madhësisë së nöfllave dhe proceseve alveolare të tyre si fakt që madhësia dhe forma e çdo organi është në vartësi të drejiperdrejtë me funksionin e tij (1, 5). E njëjtë gjë mund të thuhet edhe për aparatin përtypes nuk kryen atë funksion që ka kryer më parë. Kjo sotme, aparati përtypes nuk mund të shpreh në përgjithësi dhe nöfullat në veganti. Si rezultat i përpunimit të ushqimeve në kohën e sotme, aparati përtypes nuk kryen atë funksion që ka kryer më parë. Kjo çon pra ne zvogëlimin e madhësisë së nöfullës dhe atrofisë e saj. Mëqenëse, sic duket, një fenomen i tillë njeri shumë më shpesht në nöfullat se sa tek dhëmbët, papajtueshmëria e madhësive të proceseve alveolare dhe sistemit dentar vjen gjithmonë duke u theksuar. Kjo mnungesë vendi i detyrion dhëmbët që të kryejnë daljen e tyre në pozicione nga më të ndryshmet. Përsa i takon përhapjes në vartësi seksji, të dhënat tonë treguan se ato ndeshen pak më shumë në femra (19.5%) dhe më pak në meskujt (15.6%). Në vartësi grup-moshë, përhapa më e madhe e tyre ndodhet në grup-moshën 13-18 vjeç, që përkon me sistemin e dhëmbëve të përhershën.

Pasqyra nr. 4

Përhapia e anomalive të pozicionit sipas grup-moshave

Grup-Mosha	Me anomali pozicioni		Femra me anomali pozicioni		Meskuj me anomali pozicioni	<i>t</i> / <i>t</i> _{2,1}
	abs	%	abs	%	abs	%
3-6 vjeç	12	2.1	4	1.7	8	2.2
7-12 vjeç	469	18.5	251	21.0	218	16.2
13-18 vjeç	535	20.3	320	21.6	215	18.5
3-18	1016	17.7	575	19.5	441	15.6

Përsa u përket llojeve të ndryshme të anomalive të pozicionit të dhëmbëve, padysnim që vendin e parë është rrotacioni i tyre. Sipas të dhënavë tonë, rrotacioni përbën 59.7% të të gjithë anomalive të pozicionit. Në këto anomali mbizotëron kryesisht distorrotacioni me 33.5%, ndërsa neziorrotacioni me 21.5% të anomalive të pozicionit, ndërsa vendin e dhëmbëve me 26.2% të anomalive të pozicionit, ndërsa vendin e tretë vendosja palatinale e tyre me 15.1%. Shumë rrallë takohen vendosja nën okluzion (blokim) (2.8%) dhe mbi okluzion (0.7%), që shihet vegenërisht në periudhën e sistemit të përzjeter dhe në atë të dhëmbëve të përherëshëm, që lidhet sidomos me daljen e kanineve.

II) *Anomalitë e kontaktit të dhëmbëve prerës qendrës (diastema). –* Kjo anomali, që karakterizohet me qenien e hapësirës midis këtyre dy dhëmbëve, përsa i përket përihapjes, ze vendin e dytë. Gjatë kontrollave tonë, ajo u takua në 6.2% të famijave me një mbizotërim të pakët në femra (6.6%), kundrejt meshkujve (6.7%). Shpeshtësia më e lartë e kësaj anomalie u takua në grup-moshën 7-12 vjec, gjë që përkon me sistemin dentar të përzjere. Përveç shkaqeve të tjera, sipas mendimit tonë të disa autorëve të tjere (2, 8), kjo lidhet me procesin e ndërrimit fiziologjik të dhëmbëve të përkohshëm, dhe zëvëndësimin e tyre me dhëmbët e përherëshëm. Në këtë rast, një rendesi të madhe lot dhe zëvëndësimi ësse ndërrimi i kanineve. Disa autorë (9) e kanë takuar atë në 9.1% të tyre. Të dhënat nibi përihapjen e diastemës në vartësi sekshi të grup-moshën paraqiten në pasqyrën nr. 5.

Pasqyra. nr. 5

Grup-moshë	Më anomali diasteme	Femra me diasteme		Me shkak me diasteme	
		Abs	%	Abs	%
3-6 vjet	13	2.3		5	2.0
7-12 »	205	8.1		102	8.5
13-18 »	137	5.2		85	5.7
3-18 »	355	6.2		192	6.6
				163	5.7

Diastema përqëndrohet më shpesh në harkun dentar të nöfultës së sipërmë. Siç duket, kjo lidhet më veçoritë shumë të ndërlikuara të zhvillimit embrional të sektorit median të maksilës në krahasin më atë homolog të mandibulës. Përveç diastemës primare, që klinikisht vërehet rrallë, në praktikën e përlitshme ndeshen diastema nga më të ndryshimet, të shkaktuara nga momentet mjaff të larmishme etiologjike: frenulum i buzës abnormal, elemente dentar mbi numr, agenezia dentare, nga anomalitë e vendosjes së dhëmbëve, pozicioni dhe drejtimi i tyre nga diastema në mes madhesisë dhe vällinit, ndërmjet dhëmbëve dhe procesit alveolar, nga crrregullimet morfollogjike dhe funksionale të gjuhës, di-zarmonia midis dhëmbëve të sipërmë dhe të poshtëm etj.

III. – *Anomalitë e strukturës së dhëmbëve. –* Nga të dhënat tonë stomatologjike, anomalitë e strukturës së dhëmbëve u ndeshën në 1.8% të fëmijëve të vizituar. Kjo lloj anomalie rezultoi me të njëjtën përihapje në të dy sësset dhe me mbizotërimin në grup-moshën e dytë 7-12 vjet (2.8%).

Përhapja e anomaliave të strukturës ne vartesi të caktuar dhe grup-moshës

Paqyrat m. 6

Grup-moshë	Me anomali struktura			Femra me-anomali struktura			Meskuj me-anomali struktura		
	Abs	%	Abs	Abs	%	Abs	%	Abs	%
3-6 vjeç	2	0.3	—	—	—	2	0.6	—	—
7-12 vjeç	71	2.8	32	2.7	39	2.8	—	—	—
13-18 vjeç	32	1.2	20	1.3	12	1.0	—	—	—
3-18 vjeç	105	1.8	32	1.8	53	1.8	—	—	—

Në pjesën më të madhe, anomalitë e strukturës (hipoplazia, amelogenesis imperfecta etj) përqëndroheshin në dy ose katër dhëmbët e përparshtëm, shpesh të gërshtuar edhe me dhëmballat e para të përhershme. Por në rastet shumë më të rralla, ajo është vërejtur edhe në kaninet dhe më rrallë në paradhëmballët. Shkalla klinike e shiftrat së tyre, në rastet që ne kemi vënë re, ishte e ndryshme. Ajo fillon me defekte të lenta strukturale, me ndryshime ngjyre dhe shkonte deri në dëfekte më të mëdha në formë ullueash transversale të thella, si pasojë e të cilave disa herë ishte shkaktuar thyera e pjeshtme e koronës së dhëmbit si ajo e brinjës incizale. Në dhëmbët e përkohshëm, hipoplazia u vu rë njëjtë rrallë. Në pak raste, që i përtasim grup-moshës 3-6 vjeç, ajo ka qënë e përqëndruar në dhëmballët e parë të përhershëm.

IV. — Anomalitë e numrit të dhëmbëve. — Ngaj të dhënat e kontrollit të rasteve tonë në moshën 3-18 vjeç, anomalitë e numrimit të dhëmbëve u takuan në 1.7%, të fëmijëve. Në këtë lloj anomalie, në një përhapje shumë të shpeshtë, u takuan hipodontia në 1.6% dhe hiperodontia në 0.1%. Një mbizotërim i pakët i anomaliave edhe në këtë rast u takua në femrat dhe në grup-moshën 13-18 vjeç, që i përkon sistemin dentar të përhershëm. Një autor (7) hipodontinë e ka gjetur në 1.4% të fëmijëve ortodontikë.

Të dhënat tonë nabi përhapjen e anomaliave të numrimit të dhëmbëve në fëmijët në vartesi të sekshit dhe moshës i paracësim në pasqyrën nr. 7.

Paqyrat m. 7

Grup-moshë	Me anomali numri	Hypodontia				Hyperodontia			
		Femra		Meskuj		Femra		Meskuj	
		Abs	%	Abs	%	Abs	%	Abs	%
3-6 vjeç	1	0.2	—	1	0.3	—	—	—	—
7-12 vjeç	21	0.8	2	0.1	13	0.3	4	0.3	0.15
13-18 vjeç	79	2.9	48	3.2	29	2.5	—	2	0.17
3-18 vjeç	101	1.7	50	1.6	43	1.5	4	1.18	0.14

(1, 3, 5) nuk paraqesin me përpiknëri anomalitë e numrit të dhëmbëve. Kjo shpjegohet nga fakti, sepse përsë i përket hipodontisë në shifrin e lartpërmëndur, që ne kemi ndeshur, nuk përfshihet mungesa e dhëmballëve të pjejkurisë, ndonëse takohet njëtë shpesht në moshat që kemi pasur nën kontroll, ku shumica nuk kishin dale ende. Ndërsa për depistimin e hiperodontisë do të ishte e domosdoshëm kontrolli radiologjik masiv, gjë që për ne dhe për të tjerët ka qënë e pamundur të bëhet.

Megjithatë, përhapja shumë e gjëzë e hipodontisë tregon se sistemi dentar, në fazën e tanisme, përbën një organ të paqëndrueshëm dhe se në të ardhmen e pret një pakësim i sigurtë i numrit të dhëmbëve.

V. - *Anomalitë e madhësise së dhëmbëve.* – Ndonëse në planin terapeutik, anomalitë e madhësise së dhëmbëve nuk i përkasin profilit ortodontik, si formë e vegantë e anomalive të dhëmbëve, ne i studjuam ato në aspektin epidemiologjik të tyre. Sipas materialit, tonë, anomalitë e madhësise së dhëmbëve u ndeshën në 0.8% të fëmijëve me një mbizotërum të paket në fëmrat dhe kryesisht në grup-moshën 13-18 vjeç.

Përhapja e anomalive të madhësise së dhëmbëve në varësi sekti dhe grup-moshës

Grup-moshë	Me anomalji madhësie	Mikrodonci				Makrodonci			
		Femra		Meskuj		Femra		Meskuj	
		Abs.	%	Abs.	%	Abs.	%	Abs.	%
3-6	vjeç	2	0.3	—	—	—	—	2	0.6
7-12		9	0.3	5	0.4	4	1.2	—	—
13-18	vjeç	39	1.4	19	1.3	17	1.2	3	0.2
		50	0.8	24	0.8	21	0.9	0.1	0.6

Përhapja e lartë e mikrodoncisë flet gjithashu për vazhdimin e reduksionit filogenjetik të sistemit dentar në vegantë që aparatit përtypës në përgjithësi. Ky fakt do të pasohet me zvogëlimin e vazhdueshëm gjithashu të nofullave, me pakësimin e vendit për dhëmbët përkates dështim studimin e treguesve epidemiologjikë nbi përhapjen e anomalive të dhëmbëve veçanërisht tek fëmijët.

PERUNDIME

- 1) Si pjesë përbërëse të anomalive të sistemit nofulla-ftyrë, anomaliatë e dhëmbëve në fëmijët e qybetit të Tiranës kanë një përhapje përkrahësht të gjëre (28.46%).

- 2) Anomalitë e dhëmbëve u takuan më shpesh në periudhën e kafshimit të përzirë 30,40% dhe të përhershëm 31,40% me mbizotërim tek femrat.
 - 3) Ndër anomalitë e dhëmbëve, vendin e parë e zhinë ato të pozicionit me 17,70%.
- Dorëzuar në Redaksi më 15 qershor 1979

B I B L I O G R A F I A

- 1) Amiti M.: Anodontie partielle ou agénésie. Revue française d'onto-stomatologie 1976, 1, 218.
- 2) Barque I.: Ethiopathogénie des diastèmes interincisifs. Revue d'onto-stomatologie du midi de la France 1970, 1, 120.
- 3) Graf H.: Möglichkeiten der Entstehung und Behandlung des verlängerten und retinierten Franzathes. Deutsche Stomatologie 1975, 8, 530.
- 4) Ibra Dh.: Orthodontia. Tirane 1972, 120.
- 5) Monteil M.: Contribution à l'étude des agénésies dentaires. Revue française d'onto-stomatologie 1963, 1, 136.
- 6) Napadov M. A.: Orthodontikeskii atlas etiologii patogeneza i profilaktika detormaci zuboceljustrov. Kiev 1967, 10.
- 7) Pepa P.: Përhapja e anomalive maksilo-dentare në fëmijët e qytetit të Shkodrës. Shëndetësia popullore 1973, 1, 100.
- 8) Tollaro L. e bp.: Contributo clinico-statistichie une casistica ortodontia. Revue it. di stomatologia 1971, 8, 613.
- 9) Vitchi P. e bp.: Il diastema interincisivo mediano superiore. Revue it. di stomatologia 1969, 11, 1131.

S u m m a r y

FREQUENCY OF THE ANOMALIES OF THE TEETH AMONG THE CHILDREN OF TIRANA

A stomatological survey was carried out among 5724 children aged between 3 and 18 years in the city of Tirana. Of those, 2910 were girls and 2814 boys. In 1627 (28.46%) were found various anomalies of the teeth, more among the girls (30.9%) than among the boys (25.8%). The anomalies were more frequent in the age groups of 7-12 and 13-18 years.

The anomalies were more frequent in children with mixed dentition (30.40%) and with permanent dentition (31.40%), particularly among the girls.

First among the anomalies were those of position (17.7%).

The paper analyses the various forms of the anomalies presented in the accompanying table.

Résumé

DIFFUSION DES ANOMALIES DE LA DENTITION CHEZ LES ENFANTS DE LA VILLE DE TIRANA

Les auteurs du présent article ont effectué un dépistage stomatologique parmi 5724 enfants, dont l'âge varie de 3 à 18 ans, dans la ville de Tirana. De leur nombre, 2910 sont des filles et 2814 des garçons. Chez 1627 d'entre eux (28,46%) les auteurs ont constaté différentes anomalies des dents, et cela avec un fréquence de 30,9% chez les filles et de 25,9% chez les garçons. Ces anomalies concernent plus souvent les groupes d'âge de 7 à 12 ans et de 13 à 18 ans.

Les anomalies des dents sont plus fréquentes dans la période de la mastication mixte (30,40%) et permanentes (31,40%) chez les filles.

Les anomalies plus fréquentes sont celles concernant la position des dents (17,7%). Dans cette communication, les auteurs analysent les formes de ces anomalies et les illustrent avec des tableaux.

DY RASTE ME SARKOIDOZE TE REGIONIT MANDIBULAR

— SHKENCËR VINIT —

(Artikulli i Këtij Shkencës Shtetërore)

Për herë të parë qëndrueshme përkalluar në 1869. Po më kështu viteshët përshtkuar si "tupa spontane".

Sarkoidoza përcaktohet me shumëshësi të madhe përfshirë diagnozat e tij me mjekuar (2, 3), *akromegali*, *osteoporoza* ndërsa i nd. përmë tepë, tukoreja si stemin limfatik, *lymphonodulite* më shumë e rrallët e kaktoret kryesisht në gjendrat tresh veshit.

Në 159 raste, një vjeti përfshirë 15 raste, tyre i ka pasur më i lokaçizm në parotis, dy të tjera kanë bazuar në tjerë semundje në 6 raste më i lokaçizm zën të tillë. Autore të tjera jepin shifra ende më të ulta (cituar nga 6).

Duke u nisur nga fakti se sarkoidoza është një nozologji e rrallë dhe që diagnostikohet me vështirësi, përshtkrimi i dy rasteve tonë mendojmë se paraqet interes, sidomos për të bëre diagnozën diferencale me sëmundje të tjera të regjionit maksilo-facial si tumore, kista, adenopati specifike ose jo-specificke etj.

Rasti i parë. — I sëmuri M. D., vjeç 17, shtrohet në spitalin nr. 1 më 2 gusht 1976 me kartelë klinike nr. 7464 dhe diagnozë dëgimi *S.Ca mandibulae sin.* Sëmundja i ka filluar para tre vjetesh. Në një klinikë tjetër është operuar me diagozën kist follicular i trupit tënofullës së poshtane nga ana e majtë. Para 5-6 muaj, të sëmurit i del një kokë e vogël nënnofull nga ana e operuar, e cila rritet vazhdimisht, e shoqëruar me dhembje të lehta. Për këtë dërgohet në dispensari, ku trajtohet me streptomicina dne trekator. Mëjëni me mjeckimi nuk pati rezultat të mirë, i sëmuri dërgohet në spitalin tonë përpërcaktim diagnoze dhe mjekim.

Objektivisht ai paraqiste asimetri të fytyrës me edemë në regjionin submandibular dhe submental. Në prekje, edena ishte e fortë, pa adenonë rre me indet për rrëth. Për organet e tjera nuk kish ankesa. Në klinikenë tonë, fillimisht u mendua përmë një limfopati kronike, e shoqëruar me patologji të panjohur të kockës sënofullës, për këtë qëllim in bë dhe grafia, në të cilën u vërejt destruksion kockor në *ramus horizontalis mandibulae sin.* me konture të rrregullta (Fig. 1). U mendua përmë *neoplasma*. Për këtë qëllim u vendos që të bëhet ndënhyrje në kockë përmë përcaktuar natyren e patologjisë. Ndërryria u bë në formën e cistotomisë me hedje [754], rrënjet e 7 ishin plotësisht të rezorbuar, ndërsa ato [45] pjesërisht. Tufa neurovaskulare nënofullës së poshtme ishte e rrethuar nga ind patologjik me konsistentë karbogjinozë. Biopsia nr. 2477 datë 30.IX.1976 rezultoi: sarkoidozë e nöfullës. Kjo na bëri që të mendojmë se dhe limfonodulat submandibulare du-




Fig. NR. 1
het të keni natyrë sarkoidike, prandaj të sëmurit iu bë një ndërhyrje tjetër për hedjen e tyre, qe sipas biopsisë nr. 2694 datë 25.X.1976 rezultoi sarkoidozë e limfonodudit (fig. 2).

Analizat e tjera paraklinike dhanë këto rezultat: radioskopia dhe radiografia e mushkërive pa shinanë patologjike, zemra normale. U bë grafi e anësive, të cilat rezultuan me osteoporozë të lehtë të dorës dhe të këmbës së majtë. Gjaku dhe urina pa shmangje nga norma, me përjashtim të një limfocitoze jo shumë të theksuar (40%).

Rasti i dytë. — E sëmura H. V., vjeç 47, shtrrohet në spital më 17 janar 1979 me kartellë klinike nr. 442/ /22. Diagniza e dërgimit suspect me regionis *submandibularis sin.*, diagnoza klinike suspect sarkidoze e limfonodudit. Sëmundja i ka filluar para 25 vjetëve, ka anktuar për tharje goje, dhembje të lehti të anën e sëmure, vështirësi në gjelltje qe dalje e një gjendre nën nöfullën e poshtme me permusat e një lajtnie.

Fig. Nr. 2

Për rrëth 24 vjet e sëmura është trajtuar me streptomicinë e biperçinile. Para një viti streptomicina i dha reaksion, prandaj e ka ndëprerë mjeqim.

Gjatë kësaj kohe ka pasur periudha që masa reduktivej, sidomos gjatë kohës së barrës por jo plotësisht. Para një muaji dërgohet tek mjeku stomatolog, i cili e nis në klinikën tonë për përcaktim diagnoze dhe mjeqim.

Objektivisht e sëmura paragiste masë në regjionin submandibular sin. me madhësi sa një vezë pule, e formuar nga dy lobe të veçantë të aderuar me indet për rrëth, me konsistencë gjysëm të fortë elastike, pak e dhembshme në prekje. Limfonodule të tjera nuk preken.

Analizat paraklinike: gjaku, urina dhe radiokopia e mushkërive nuk paraqisin shëmangje nga norma.

Më 18 janar 1979 e sëmura u operua. I hiqen dy masa, njëra sa një vezë pule, tjetra sa një arrë. Nga biopsia nr. 130 datë 19 janar 1979 rezultoi: Sarcoidosis Lymphonoduli.

DISKUTIMI I RASTEVE

Në të dy rastet vihat re se diagnoza është vendosur me shumë 25 vjetësh. Vështirësia e diagnostikës të kësaj sëmundje janë se nuk ka shenja klinike patognomonike, që të flasin për sarkoidozë, sidomos të regjionit maksilo-facial (5, 6). Edhe analizat paraklinike nuk na ndihmojnë shumë për këtë problem, megjithëse në literaturë thuhet se vërehen këto ndryshime si sed. i lartë, prirje për leukopeni monocitoze dhe eozinofili, por këto nuk janë karakteristike (4).

Në rastin e parë, sëmundja ka filluar si sarkoidozë e kockës së nofulles dhe është marrë gabimisht për kiste folikulare, pasi në këtë destruktioni në moshën kur është shfaqur sëmundja 13 vjeç mund të ketë pasur ndonjë dhëmb të pa eruptuar; me vonë janë prekur imfoglandulat submandibulare. Në të dy rastet kur janë prekur limfoglandulat, sëmundja është trajtuar për procese tuberkulare, megjithëse nuk ka pasur në fakt të gjitha ato karakteristika të një adenopatie tuberkulare.

Përmirësimet që ka pasur e sëmura e dytë, sidomos gjatë barrës, kanë ardhur jo si rezultat i mjeqimit, por nga prija që ka kjo sëmundje në raste të ralla për vëtëshërin, ose ka ndikuar shtatëzënia, pasi në këtë periudhë, placenta prodhon hormone, shthohet sasia e estrogeneve, hormoneve hipofizare dhe kortikosteroideve (7).

Të dy rastet, fillimisht në i kemi mjequar me rrugë kirurgjikale, heqjen e noduleve sarkoidike dhe, në rastin e parë edhe pastrimin e mirë të kockës nga indi patologjik, shogëruar me kortikoterapi përnjë kohë të gjatë për rrëth dy vjet. Në film prednisoni u dha me doza 40-60 mg/r. më pas ato u reduktouan gradualisht deri sa arriten nën një dozë mbajtëse 5-10 mg/r.

Rastin e parë, që po e ndjekim për atro 3 vjet e kemi kontrolluar disa herë. Në radiografi, kocka duket e shëndoshë (fig. 3). I sëmuri nuk ka asnjë ankesë (fig. nr. 4). Rasti i dytë është i freskët dhe pas operacionit vazhdon mjeqimin me kortikosteroidë.



Foto Nr. 3

Përfundim: Përshkrimi i këtyre dy rasteve tregon se kjo sënum-dje, me gjithëse takohet rrallë, ajo mund të jetë e pranishme edhe në regionin maksilo-facial, prandaj duhet të kihet parasysh në diagozën differenciale me neoplazitë malimje; sëmundjet sistemike, limpatitë e këtij regioni, TBC ekstrapulmonar me prekje të gjendrave submandibulare ose submentale etj.

Dorëzuar në Redaksi më 10 qershor
1979




Foto Nr. 4

B I B L I O G R A F I A

- 1) Alhani J. E.: Traktati i sëmundjeve të brendshme, Tiranë 1974, Vol. I, fq. 549.
- 2) B M E 1960, Vol. 29, fq. 391.
- 3) Çogoli H.: Karakteristika të adenopatisë traheobronkiale tuberkulare të të rinjtë dñe të rinjut. Buletini i UT – seria Shkenca Mjekesore 1978, I, 25.
- 4) Fatturuso V., Ritter O.: Vademekum mjekësor për praktikën klinike (përkthim shqip), Tiranë 1970, 563.
- 5) Popkistov P.: Bolesti na ligavica na ustate. Sofia 1958, 173.
- 6) Propp R., Komnev V., Jakubov A.: Redkoe soçetanie smesanoj opuholi i sarkoïdoza okoloushnik sljunih zhelez. Stomatologija 1968, 5, 88.
- 7) Shediiku E.: Vështirësia e diagnostikimit dhe mjekimit në sarkoidozën pulmonare. Shëndetësia Popullore 1976, 3.

Summary

TWO CASES OF SARCOIDOSIS OF THE MAXILLO-FACIAL REGION

Two cases are described of the maxillo-facial region in merit of their rarity and the difficult diagnosis.

In these cases the diagnosis was determined late and after being treated for other illnesses.

On the basis of these two cases and other reported by other authors, it is suggested that sarcoidosis should be considered in the differential diagnosis of various protracted processes of the maxillo-facial region such as benign tumours, various systemic diseases, lymphopathy, sialopathy, extrapulmonary tuberculosis involving the submandibular and sublingual glands etc.

These two cases received combined surgical and medical treatment, the operation followed by a long course of corticosteroid therapy.

Résumé

DEUX CAS DE SARCOÏDOSE DANS LA RÉGION MAXILLO-FACIALE

L'auteur du présent article décrit deux cas de sarcoidose de la région maxillo-faciale et il relève qu'il s'agit d'une maladie que l'on rencontre rarement dans cette région et qu'il est difficile de la diagnostiquer.

En effet dans ces deux cas aussi le diagnostic a été établi très tard, du fait que les patients avaient été traités initialement pour d'autres maladies.

Partant de ces deux cas et des données de la littérature spécialisée, l'auteur est d'avis que dans toutes les maladies prolongées de la région maxillo-faciale: néoplasies bénignes, limphagites, sialorhées, TBC extra-pulmonaires avec atteints des glandes submaxillaires et submentales etc., il faut avoir présent à l'esprit la sarcoidose pendant le diagnostic différentiel.

Ces deux cas ont été traités de façon combinée: intervention chirurgicale et thérapie prolongée avec des cortisones costéroïdes.

EKSPERIMENTALE

ROLI I DOZAVE TE ENDOKSANTIT NE MJEKMIN E HEPATITEVE KRONIKE EKSPERIMENTALE

– Prof. JOSIF E. ADHAM – REXHEP BREGU – FATMIR OSTRENI –

(Katedra e sëmundjeve të brendshme dhe lënda e fizioloshisë të fakultetit të mjekësisë dhe instituti i kërkimeve veterinarë)

Në një punim të mëparshëm (2) mbi veprimin e acetatit të hidrokortizonit dhe endoksanit në hepatitet kronike eksperimentale vumi re se në hepatitet toksike të shkaktuar nga CCl₄, përdorimi i endoksanit me 2 mg për kg. pesë e pengonte zhvillimin e fibrozës hepatike, më pak atë të nekrozës, kurse diastrofa yndyrorre dhe infiltrimi i hapësirave portobiliare pothuajse nuk ndryshon. Ndryshe nga ky, përdorimi i hidrokortizonit me 10 mg. për kg. pesë sillte përmirësimë të dukshme në të katër kriteret histologjike të vlerësimit të dëmtimeve hepatike. Por nga ana tjetër, po të krahasojmë dozat e hidrokortizonit të përdorura në atë eksperiment me ato që zakonisht përdorim në klinikë, shohim se janë shumë më të mëdha se ato të endoksanit. Kjo na bëri të mendojmë se ndryshimet që shiheshin midis rezultateve të këtyre preparateve mund të qene pasojë e diferençës së dozave të tyre. Për këtë qëllim vendosëm të bëjmë një eksperiment tjetër, ku dozat e acetatit të hidrokortizonit të mbeteshm të pandryshuara, kurse ato të endoksanit të dyfishtoheshin dhe të katërfishoheshin.

METODIKA DHE KOMA E TRAJTIMIT

Eksperimenti zgjati nga 12 tetori i viti 1976 deri në 24 mars 1977 dhe përbëhej nga 33 minj të bardhë (23 meshkuj dhe 10 femra). 30 minj u ndanë në tre grupe nga 10 secili dhe u trajtuan për tre muaj me tetraklorur karboni 50% në vaj misri me dozë 1.3 ml. për kg/pesë, i injektuar subkutan 2 herë në javë, njëloj si në një punim të mëparshëm (2, 10).

Të gjithë minjve iu bënë nga 27 injektime, me përjashtim të njëjtë që iu bënë 28 dhe një tjetri 23. Ky i fundit u trajtua vetëm për dy muaj e gjysmë, pasi ngordhi vëtë para kohe nga konvulsione të shfaqura menjëherë pas injektimit të 23-të. Të dy këta minji bënin pjesë në grupin e kontrollit, i cili u trajtua vëtëm me tetraklorur dhe nuk u mjekuar me kortizonikë as immunodepresorë, siç u veprua me dy grupet e tjere. Përveg këtyre tre grupeve, të minjtë e fundit u mbajtën në të njëjtat kushte mijëdisi dhe ushqimi, pa u trajtuar me asnjë preparat, me qëllim që të krahasoheshin rezultatet e ekzaminimeve të minjve me hepatite kronike, me këto të minjve të shëndoshë.

1. Grupi i vërtetë i kontrollit i trajtuar vetëm me CCl₄, përbëhej nga 10 minj me peshë fillestare mesatare 186.6 ± 18.4 gr. Me qëllim që ndryshimet hepatike të shiheshin në stade të ndryshme të sëmundjes, vendosëm që sakrifikimin ta bënim tre ditë, një muaj dhe dy muaj pas

ndërprerjes së injektiveve të tetraklorurit të karbonit. Kjo gjë u bë edhe për të parë nëse midis minjve të mjekuar për një ose dy muaj pës ndalimit të CCl₄ dhe atyre të pamjekuar do të kishte ndryshim, gjë që do të na lejonte të kuptojmim nëse përmirësimet në kuadrin histologjik të mëlgisë qenë pasoje e përdorimit të medikamenteve, apo një proces riparimi i vëtë organizmit, i cili nuk kishte lidhje me kortizonikët apo imunddepresorët.

Për të krijuar midrasë maksimale, nën konjunktivë u injektua sol adrenalinë 1 për mijë, por nuk qe e mundur të bëhej shkëputje e sive. Kjo u arrit vetëm duke hyrë me spatul nëpër plagën korneale. Carija kapsulare u zgjerua. Jashtë saj dilinë masa të shumta kataraktale. Me shiringë nepërmjet një kanyle të gjéré u bë thithja e kataraktës dhe lavazhi i dhomes së përparsime. Zona papiliare u pastrua mire. Ndërkq, në zonën e trupit ciliar, në pjesën e poshtme, midis orës 5 dhe 6, u vërejt eksudat me ngjyrë në të verdhë, që i përgjigjet vendosjes rontgenografike të copës.

Me magnetin e dorës u bë prova magnetike, e cila rezultoi negative. U orvat për aspirim (thithje) të trupit të huaj. Copia u bë e duksum, pastaj ajo u zhystë në trupin qelqor, gjë që e vështirësoi së tepërimi mundësinë e largimit të saj.

Largimin e trupave të huaj të vendosur në segmentin e pasëm të syrit, autorë të ndryshëm e Japin në dy mënyra: transkorneal dhe transkleral. Kjo e fundit është më e preferuara, madje e vetme për largimin e trupave të huaja. Jomagnenikë të vendosur në trupin qelqor. Kjo arrihet pas prerjes meridionale të sklerës, shtresë pas shtrese, në zonën që i përgjigjet vendosjes së copës. Preria bëhet zakonisht e gjata. Ajo kalon nga 5 në 8 mm (6) madje dhe deri 12 mm (1). Ka autorë (cituar nga 1) që rendon komandojnë preparimin e një lamojoje sklerale. Në çdo rast, më parë vendoset suturat dhe pastaj bëhet diatermoelektrokoagulacion skleral.

Si hapet koroidea e retina, çast që mund të pasohet nga hemorragji e madhe në trupin qelqor, provohet kapja e trupit të huaj me një nga pinçat e imta të ndërkuara për këtë qëllim. E njohur është pinca vitrale e Desmarri, që, e mbyllur futet si një gjilpërë drejt trupit të huaj, ku si hapet vetëm fundi i saj, me të kapet trupi i huaj.

Për trupa të rrumbullakët janë ndërtuar pinca me dy kapëse në formë lugësh të vogla, që hapen e mbyllen. Për këto ka vështirësi në kapje, sepse gjatë mbylljes e shtyjnë trupin qelqor dhe bashkë me të edhe trupin e huaj (10).

Një autor ka ndërtuar metodën e tij me anën e një kërkuesi metarlesh spas Comberg dhe vëzhgimin radiologjik të syrit. Një autor tjetër

Përdor të ashtuquajturat radio-sondë e radio-pincetë të lindura me një radio-aparat, që punon me bateri. Takimi i sondës ose pincës me trupin metallik pasohet nga një sinjal i fortë dhe ndërkaq është zbuluar vendi ku ai ndodhet. Autore të tjera kanë ndërtuar të ashtuquajturen. «telefoni pincetë», kurse një tjetër një metodë Rontgen-televizive (ctuar nga 1, 7, 10).

Për të dëmtuar syrin sa më pak, një autor këshillon thithjen e trupit të huaj me shiringë, ku maja e kanyjës ka formë pak a shumë të një hinke, tek e cila, nga thithja, trupi i huaj ngjeshet. Për thithje janë të përshtatshëm vetëm trupa të huaj me njëpërshtatshëm voga (8, 9).

Duke përbledhur mund të themi se në gjë rast ndihmon përvaja e seclit për të manovruar me shpejtësi dhe shkakthësi në keto ndërhyrje teknikisht të vështira, që shpesh shoqërohen me ndërlidhje gjatë operacionit.

Duke u ndodhur para një syri me plagë korneale, tashmë afak, me një copë metallike jo magnerike të zhystur thellë në trupin qelqor, na lindi mendimi për zbatimin në këtë rast të metodës së Barranger J. e të modifikuar sipas disa autorëve të mëvonshëm sipas së cilës bëhet transfiksimi i kristalines së luksuar prapa pupiles me ndihmën e dy gilpëkave, duke e pasur të sëmurrin të vendosur mbi tryezën e operacionit në pozicion barks (2, 4).

Në fillim zgjeruan plagët korneale 1 mm drejt periferisë, pastaj vendosëm një suturë paraprake dhe mbushëm dhomën e përparshtme me serum fiziologjik. Të sëmurrin e kthyem barks. Pas një çasti copë metalike bie prapa kornesë. Ajo kish njyrrë të verdhë. Kokës së të sëmurit iu dha një pozicion që copa të binte mbi vendin e perforacionit. Sutura lironet me shpejtësi dhe pinca futet në kamer. Si kapëm trupin e huaj e larguam atë menjëherë nga syri. Forma e tij ishte ajo e një sagme me diametër 1.5 mm. Të sëmurrin e vendosam përsëri në kurris dhe me përfundoi dhe ndërhyrja operatore. Syrit iu vendos pomaqë tetraciklinë dhe pastaj fashaturë binokulare.

Më vonë i sëmuri u mijekua me bipeniclinë, strepto nicinë, delta-me pikë atropini sulfurici 1% ung. tetraciklinë, të ngrohta, ultrakorten subkonjunktival e pomadë kortizonike.

Syri ardhë duke u qetësuar dhe, si përfundim, në korne u krijua një lekumë linare pas së cilës u ngjiti një membranë e hollë eksudati të organizuar që vjen nga superto-temporal. Pupila ishte në midisëz maksimale. Në trupin qelqor, në pjesën e poshtme, u gjend një zone e kufizuar me eksudat të organizuar në afersi të trupit ciliar. Papila e nervit optik ishte normale, po kështu dhe retina në polin posterior. Me xham

trupa të huaj metallik jo magnetik të vendosur në *corpus vitreum*, kur të sëmuret janë paragjitur shpejt dhe eksudati ende nuk i ka fiksuar ata dhe kur kristalina është e turbulluar, mënyra e mësipërme, që në vetëvete është një mënyrë transkorneale (që mund të kryhet edhe pas punksionit të kameras) na duket shumë e përshtatshme dhe teknikisht e rëllizueshme nga çdo mjek, që kryen ndërhyrje bulbare.

Largimi i kristalinës, në rast se indikohet, na duket se vlen të kryhet për t'i hapur rrugën pupilare trupit të huaj të ndodhur në *corpus vitreum*, kur trupi i huaj nuk është magnetik dhe me përbërje lëndësh, që nuk durohen nga syri dhe që e rrezikojnë atë seriozisht.

Dorëzuar në Redaksi më 20 prill 1979

BIBLIOGRAFIA

- 1) Blaskevics, Kettész, Vorosmarty: Eingriffe am Auge. Stuttgart 1970, S. 461.
- 2) Cepa Gj.: Subbulksacionet dhe lëksacionet e kristalinës në trupin qelqor dhe mundësia e ekstraksionit të saj. Shëndetësia popullore 1974, 1, 86
- 3) Cepa Gj., Papa A.: Dëmitmet perforative të syve. Buletini i UT – seria shkençat mjekësore 1976, 2, 127.
- 4) Hollwich F.: Zur Operation der luxierten Linse. Oesterreichische ophth. Gesellsch. 6 Jhv. Salzburg 1961, 74.
- 5) Kristichi K., Cepa Gj.: Syri dhe sëmundjet e tij. Tirane, 1973, 429.
- 6) Moller J., Bock J.: Augenärztliche Eingriffe. Wien 1950, 442.
- 7) Müller K. H.: Die Behandlung der Kriegsverletzung des Auges im Felde in Opht. Operationslehre Herausg. Leipzig 1945, 952.
- 8) Neubauer H.: Zur Technik der Entfernung frei im Glaskörper schwimmender amalgamatischer Splitter. Heidelberg 1953, 332.
- 9) Neubauer H.: Zur Extraction amalgamatischer Glaskörpersplitter mittels Aspirat. Klin. Mbl. Augenk. Bd. 1962, 140, 734.
- 10) Thiel R., Hollwich F.: Therapie der Augenkrankheiten. Stuttgart 1970, S. 301.

Summary

A SPECIAL TECHNIQUE OF REMOVING NONMAGNETIC FOREIGN BODIES FROM CORPUS VITREUM

A case is described of an injury of the right eye by the explosion of the capsule of a cartridge.

Apart from the corneal perforation, the patient presented a traumatic cataract with rupture of the lens capsule and the presence of cataract masses in the anterior chamber.

After aspirating the patient was placed in a position lying on his stomach, which facilitated the passage of the foreign body into the anterior chamber, from where it was extracted with the aid of a forceps through the corneal perforation.

The author believes that this method is worth trying by first removing the turbulent lens in order to create free passage for the foreign body (nonmagnetic) which is not tolerated by the eye and is located in corpus vitreum near corpus ciliare at a time when the process of organization has not yet developed.

Résumé

UNE TECHNIQUE SPÉCIALE POUR ENLEVER LES CORPS ÉTRANGERS NON MAGNETIQUES DU CORPS VITRÉ

Dans cet article il est question d'une blessure provoquée à l'œil droite par suite de l'explosion de 1 capsule d'une cartouche.

Outre la perforation de la cornée, le patient présentait une cataracte traumatique avec rupture de la capsule cristalline et une masse de cataracte dans la chambre antérieure.

Après l'absorption de la cataracte, le patient a été placé à plat ventre afin de faire sortir le corps étranger non magnétique d'abord de la chambre antérieure et puis avec des pinces à travers la perforation cornéenne.

L'auteur du présent article soutient qu'il convient d'enlever le cristallin turbide afin de créer un passage libre au corps étranger (non magnétique) qui n'est pas toléré par l'œil et se trouve localisé dans le corps vitré, à proximité du corps ciliaire, alors que le processus d'organisation ne s'est pas encore développé.

NDERLIKIME KORNEALE NGA INDOMETACINA DHE REZOKINA

— Doc. ANDREA ARONI —

(Shkali i retit Beratit)

Dihet se nga përdorimi i barnave të ndryshme kundër artritit reumatoid mund të shfaqen ndërlikime korneale. Në vitin 1939 dy autore kanë përshtuar tablonë klinike të quajtur *chrysiasis*, që karakterizohet me depozitime kristalesh të kriprave të arit nën epitelin korneal (1). Në vitin 1958 një autor (cituar nga 3, 4) ka përshtuar ndryshime korneale nga përdorimi i *chloroquine* ("esocin, aralen"), në formën e depozitimeve të holla punktiforme të vendosura nën epitel, në drejtim radial, që divergojnë nga qendra e kornesë për në periferi. Në vitin 1964, një autor (1) ka përshtuar depozitime korneale janë të sëmurët të mijekuar me *indometacin* për një kohë të gjatë. Depozitime korneale janë përshtuar gjithashtu edhe nga përdorimi i *plaquenil (hydroxychloroquine)* dhe të preparave të tjera sintetike antimalarike (5).

Më 3 janar 1977 në spitalin e Beratit u shtrua e sëmura Q. Xh., vjeç 54, nepunëse me nr. kartele 16 me diagnostikën *Arthrosis rheumatoidea, spondyloarthrosis deformans*. Në film e sëmura është mijekuar me indometacinë nga 100 mg r. në ditë. Qysh prej datës 22 janar 1977, tre javë më vonë, është trajnuar me indometacin 150 mg, dhe rezokin 750 mg r. në ditë. Në kontrollin e syve të datës 9 shkurt 1977 shënohet: Visus me koreksion plus 2,0 D baras 1,0. Në fundus oculi u vërejtën vetëm ndryshime të lehta sklerotike të vazave retinale të gjakut.

Terapia e sipërmëndur vazhdoi gjatë shkurtit dhe marsit 1977. Më 15 mars 1977 e sëmura paraqiti ankesën se nuk shihte qartë kur përfendronte vëmëndjen në një send të caktuar. Gjatë vizitës okulistike krahas ndryshimeve të vizusit, në fundus oculi nuk u vërejtën ndryshime të tjera patologjike. Të sëmures iu rekandomua të mbajë syza për larg vazdimisht dhe iu përshtuan syza për atë. Pas një javë, gjatë së cilës e sëmura vazhdoi të njëjën terapi, ajo paraqitet e shjetesar me këto ankesa: kish fotofobi dhe djeqe të të dy syve, sidomos të syrit të majtë. Me këtë sy nuk shihte mire, ndjenje se kishte një veshje të pamjes. Ekzaminiimi objektiv vuri në dukje injektiun të lehtë të perzjere në të dy sytë, por në syrin e majtë, inkaktimi tiliar ishtë më i theksuar. Në mikroskop u vunë të ndryshme korneale shumë më të theksuara në syrin e majtë. Në këtë sy u panë depozitime korneale punktiforme, me ngjyrë të bardhë të gri, të vendosur nën epitel, në mënyrë të rregullit, që formonin shirta të hollë, njëri pranë tjetrit ma drejtim radial dhe konvergjoni nga të gjithë anët e periferisë korneale, në drejtim të një pike të ndodhur pak nën qendrën anatomike të kornesë. Në syrin e dështrë dallohen shin gjithashtu depozitime të këlla, pak në qendër e më shumë në gjysmën superonasale të kornesë, të vendosura në drejtim

radial në formë shiritash të shkurtra dhe me ndërprerje vende-vende. Mprehëtësia e pamjes së syrit të djathëtë ishte 0,9, ndërsa ajo e syrit të majtë ishte 0,5 me koreksion.

Para kësaj tabloje klinike, të sémurës iu rekomandua të ndëpresë njekimin me indometacin dhe rezokin. Në kontrollin e bëre pas rive javë nuk u dalluan më depozitime në kornen e syrit të djathëtë, ndërsa në atë të syrit të majtë, depozitimet ishin pakësuar, këshu që shiritat ratile paraqisin aty-këtu ndërprerje. Dijetë ditë më vonë nuk u vunë re më depozitime korneale në këtë sy. E sémura nuk pati ankesa, virus 1,0 me koreksion në të dy sytë. Në kontrolllet e mëvonëshme, pas disa muaj dhe pas një vitit, u vërejt e njëjta gjendje.

Gjatë mjekimit të artritit reumatoid, depozitimet korneale shfaqen

në vartessi nga doza e përditshme dhe nga sasia e përgjithshme e barit të përdorur si dha nga koha e përdorimit.

Në literaturë më mirë njihet keratopatia, e shkaktuar nga *chloroquine*. Sipas një autorit (6), përdorimi i *chloroquine*-s me doza mësatare 800 mg. në ditë shikacion shfaqjen e depozitimeve korneale në 6% të rasteve gjatë 6 muajive të parë. Gjatë mjekimit të mëtejshëm, këto shfaqen në 32% të rasteve në 6-mujorin e dytë dhe pas 4 vjetësh shfaqen në të gjithë të sémurët. Sipas një autorit tjetër (1), keratopatia e shkakkuar nga indometacina është shfaqur në 16% të rasteve shumë muaj pas fillimit të mjekimit dhe kjo tëshë paraqitur me një tablo shumë të ngjashme me atë të shkaktuar nga *chloroquine* ose është paraqitur vetëm me opacitetë të holla të stromës korneale.

E sémura që kemi përshtruar, në fillim, u ankuua për çrrëgullime akomodative, ndërsa më vonë u shqetësua nga fenomene inflamatore dhe ulje të mprehëtësish së të parit, për shkak të keratopatisë së zhvilluar. Vendosja e rrëgullitë e depozitimeve subepiteliale korneale i njegj me shumë keratopatisë të shkaktuar nga *chloroquine* (në rastin tonë rezokina). Mirëpo dihet se ky bar eliminohet në mënyrë shumë të ngadalshëm nga organizmi (5). Duke marrë parasysh ndryshueshmërinë e shpejtë dhe të plotë të ndërlidhimit të përshtruar pas ndërprerjes 2-3 javore të përdorimit të tij, mendojmë se si çrrëgullimet akomodative ashtu dhe depozitimet korneale, në rastin tonë, janë pasojë e përdorimit tremujor të indometacines.

BIBLIOGRAFIA

- 1) Burns CH. A.: Indomethacin reduced retinal sensitivity and corneal deposits. American Journal of Ophthalmology 1968, **66**, 825.
- 2) Deutsch A., R. Hiatt R. L.: Effects of indomethacin on intraocular dynamics. American Journal of Ophthalmology 1969, **68**, 313.
- 3) Ebringer A., Colville P.: Chloroquine neuropathy associated with keratoconjunctivitis and retinopathy. Medical Journal 1967, **219**, 5546.
- 4) Physicians' Desk Reference - Medical Economic I.N. C. 1975, 1972 dhe 1614.
- 5) Poro K., Adriani J.: Reumatologjia. Tiranë, botim i UT, 1977, **33**, 46, 51.
- 6) Shearer R., Dubois E.: Ucular changes induced by longterm hydroxychloroquine (Plaquein) therapy. American Journal of Ophthalmology 1967, **64**, 245.

Summary

A case is described of corneal precipitations developing during a three month's treatment with indometacine and resochine in a patient with rheumatoid arthritis (or spondyloarthritis deformans).

The precipitations disappeared without sequelae within two-three weeks after the treatment was suspended.

It is suggested that the corneal opacities were due mainly to indometacine.

Résumé

COMPLICATIONS DE LA CORNÉE PROVOQUÉES PAR L'INDOMETHACINE ET LA RESOCHINE

Dans cet article l'auteur illustre un cas de dépôts dans la cornée provoqués par le traitement à l'Indométhacine et à la Resochine pendant trois mois chez un patient hospitalisé pour un arthrite rhumatoïde (ou spondyloarthritis deformans).

Ces précipitations furent éliminées 2-3 semaines après l'interruption du traitement, sans séquelle pour la vue du patient.

L'auteur est d'avis que ces précipitations sont dues principalement à l'Indométhacine.

MBI NJË VARIACION TË HARKUT TË AORTËS

— SAZAN GABRANI —

(Katedra Anatomi – Histologji)

Variantet e degëzimit dhe vendosjes së enëve të gjakut zënë një këto variante, ato të trungjeve supra-aortike, që furnizon harku, janë të shumta. Duke u nisur nga ky fakt, autorë të ndryshëm (2, 4, 7) janë përpjekur të bëjnë një klasifikim sa më të mirë të tyre. Nga klasifikimet e shumta, mendojmë se më praktik është ai, që merr përvazë numrin e trungjeve që dalin nga harku (7). Sipas këtij klasifikimi, dallojmë gjashë grupe të mëdhenj variacioneesh:

Grupi I: Nga harku i aortës del vetëm një trung arterial, prej të cilit dalin dy arteriet karotide të përbashkëta dhe dy arteriet ndënklavikula.

Grupi II: në këtë grup bëjnë pëse tipa të ndryshëm variaconeesh, por nga harku i aortës dalin vetëm dy trungje, të cilat degëzoohen në mënyra të ndryshme.

Grupi III: Nga harku i aortës dalin tre trungje, e këshfu me radhë.

Secili grup paraqitet në variante të ndryshme. Variantet e trungjeve që jep harku i aortës nuk janë të pakta. Sipas një studimi të kryer (2), në 302 subjekte të moshave e sekseve të ndryshme, rezulton se në 16,6% të rastevë ka ndeshur në 5 lloje të ndryshme variaconeesh të trungjeve supra-aortike. Autorë të tjere (cituar nga 2) japin një shifër më të lartë lidhur me shpeshtësinë dhe llojin e tyre (22%) dhe 7 lloje të ndryshme variaconeesh. Ndërsa autorë të tjere (4), në një studim të bérë në 161 të porsalindur, kanë gjetur 9 lloje variaconeesh, që zinin 46,5% të rastevë të rrarrura në studim. Pra numri i degëve që furnizon harku i aortës i largohet shumë përshtkim klasik. Këto variacione janë treguar shumë vonë, aty nga mesi i shekullit XIX. Deri atëherë dihet se harku i aortës jep tre trungje të mëdhenj arteriale, duke filluar nga e djathta në të majtë: 1) *truncus brachiocephalicus* (arteria anonyma), i cili degëzohet në: a) *arteria subclavia dextra* dhe b) *arteria carotis communis dextra*. 2) *Arteria communis sinistra*. 3) *Arteria subclavia sinistra*. Ky është tipi klasik i harkut të aortës dhe tipi që ndeshet më shpesht. Pakësohet, por mund të mbetet edhe tre (duke qënë ndryshe nga tipi klasik).

Ata mund të modifikohen si në ndërtimin e tyre ashtu dhe në rapportet përkafëse. Variantet e këtyre trungjeve janë shumë të larmishëm si përsa i përkët numrit, ashtu dhe përsa u përkët modifikimeve të origjinës së tyre.

Këto variacione ka rendësi të nijen sidomos nga klinicistët, pasi

ato qojnë në ndryshime të rëndësishme të raporteve të enëve të gjakut të katisit të sipërmë të mediastinit të përparshëm (5).

Por me gjithë rëndësinë praktike që ka njohja me këto variacione, në literaturë janë të paktë njofitë të kësaj natyre. Në literaturën tonë gjejmë vetëm një punim mbi një prej këtyre variacioneve (3).

Në këtë punim po ndalem i në një varacion tjetër të degëve që dalin nga harku i aortës: «dalja e arteries vertebrale të majte drejtëpërdrejt klavikulare, pëpara se kjo e fundit të futet midis muskujve shkallorë (m. scalenus anterior et medius) (6). Megjithatë arteria vertebrale e majte jo rrallë del drejtëpërdrejt nga harku i aortës. Në këto raste, vendi i origjinës se saj ndodhet midis arteries carotis communis sinistra dhe arteries subclavia sinistra. Nje vendosje e tillë e bën të lehtë diferençimin e saj nga arteria thyreoidea ima dhe arteria thoracica, interna, të cilat kur dalin nga harku i aortës, vendosen në origjinën e tyre, midis truncus brachiocephalicus dhe arteria carotis communis sinistra.

MATERIALI DHE METODIKA E PUNËS

Në studim u morrën 180 subjekte (100 meshkuj dhe 80 femra), të moshave të ndryshme, nga të porsalindur deri 96 vjeç. Si metodë studimi u përdor ajo e preparimit anatomic e plotësuar me hapjen e harkut të aortës, për të vënë në dukje edhe numrin e ostiumeve të këtyre trungjeve si dhe kalibrin e tyre.

Nga gjithë rastet u vu re se në 14 prej tyre (7,7%) arteria vertebrale e majte dilte drejtëpërdrejt nga harku aortik. Këtë variacion e ndeshëm në dy tipa: *tipi i I.* – harku i aortës në këtë tip variacioni pasi jepet: *Truncus brachiocephalicus* (Tr. B. C), *Arteria carotis communis sinistra* (A C C S), midis kësaj të fundit dha *Arteria subclavia sinistra* (A S S) jepete arterien vertebrale të majte (A V S) (foto 1, 2). Pra në këtë rast kemi të bëjmë me njërin prej variantave të grupit të IV (varianti me karter trungje supra-aortikë).

Tipi i II. – Në këtë tip, arteria vertebrale e majte (A V S) del drejtëpërdrejt nga harku i aortës, por jo si trung i katërtë. Harku i aortës, në këtë rast, jep tre trungje, njëri prej të cilëve është arteria vertebrale e majte. Në këtë rast, *arteria carotis communis sinistra* del me një trung të përkashkët me *truncus brachiocephalicus*, ndërsa arteria vertebrale e majte ndodhet midis këtij trungu (*Truncus inominatus* – sipas 6) dhe arteries *subclavia sinistra*. (foto 3, 4).

Gjatë studimit të këtij variacioni u vu re se *arteria carotis interna sinistra* kishte një kaliber më të vogël se ajo e anës së djathtë. Menojmë se ky fenomen shpjegohet me kalibrin e konsiderueshmë të arteries vertebrale të majte, që del drejtëpërdrejt nga harku. Ky fakt ka rëndësi të kihet parasysh nga specialistët, sidomos gjatë kryerjes së arteriografisë së arteries *carotis interna sinistra* ose arteriografisë vertebrale. Tipi i I i këtij variacioni u gjet në 12 (6,6%) raste, prej të cilave 8 ishin meshkuj (80%) dhe 4 femra (50%) (skica 1 a). Tipi i II u gjet vetëm në 2 raste (1,1%), që të dyja femra (pra u gjet në 2,5%) të femrave të marrura në studim), kurse tek meshkujt asnjë rast (skica 1 b).



Fig. 2




Fig. 1




Fig. 4





Fig. 3



Shpërndarja e këtyre dy tipave të këtij variacioni, sipas grupmoshave, paraqitet në pasqyrën nr. 1.

Pasqyrë nr. 1

Grupmosha	0-1 vjeç	2-10 vjeç	11-20 vjeç	21-30 vjeç	31-40 vjeç	41-50 vjeç	Mbi 50 vjeç	Shumë
Variacione	5	—	1	1	1	—	6	14
Gjith.	51	8	13	11	12	20	65	180

Sic shihet: dhe nga pasqyra, numri më i madh i rasteve u takon grup-moshave 0-1 vjeç dhe mbi 50 vjeç (gjithsej 11 raste), ndërsa grup-moshave të tjera u takojnë vetëm 3 raste. Kjo shpjegohet se edhe numri më i madh i vdekjeve është i këtyre grup-moshave. Gjithë e këtij variacioni njëloj në të dy grup-moshat ekstreme flet për atë që ky variacioni nuk ndikon në ndërtimin dhe funksionet e organizmit. Të dhënat tona mbi shpeshtësinë e këtij variacioni janë të përafarta me ato të autorëve të ndryshëm (pasqyra nr. 2).

AUTORI	Alverdes	Guyader	Adachi	Poles	Darderit etj.	Rastet tomë	Pasqyra nr. 2
TIPI I	4%	2.5%	4.8%	8.7%	6.6%	6.6%	
TIPI II	-	-	-	-	0.66%	1.1%	

P E R F U N D I M E

- 1) Variacionet e trungjeve, që dalin nga harku i aortës, zënë një vend me rëndësi midis variacioneve të ndryshme anatomike.
 2) Dalja e arteries vertebrale të majtë drejtëpërdrejt nga harku i aortës u gjet prej nesh në 7.7% të rasteve të marrura në studim.
 3) Ky variaçion u gjet në dy tipa, më shpesht në tipin e parë (6,6%).
 4) Këto variacione nuk ndikojnë në zhvillimin dhe funksionimin e pjesëve të organizmit që furnizohen nga harku i aortës.

Dorëzuar në Redaksi më 3 prill 1979

B I B L I O G R A F I A

- 1) Alverdes K.: Grundlager der Anatomie. Leipzig 1956, 247.
- 2) Dordevic S. B., Kanjun I. V.: Urodiene Sracne Mane. Beograd 1974, 236-237.
- 3) Goloshi V.: Dysphagia Lusoria. Buletini i UT – seria shkencat mjekësore 1976, 3, 137.
- 4) Guyader A., Solassol A.: La disposition des gros Trones collatéraux de la Crosse de l'Aorte du nouveau-né Africain de Côte-d'Ivoire, Anatomischer Anzeiger. Jena 1968. Bd. 118, 458, 461.
- 5) Kuprijanov V. V., Voskresenskij N. V.: Anatomičeskie varianti i oshibki v praktike vraca. Izd. Medicina 1970, 112.
- 6) Llanga K., III A., Osmanlli D., Papadopouli P.: Anatomia normale e njjerut.
- 7) Dispensa e III, 1974, 55.
- 7) Testut L.: Anatomia umana. Torino 1942, 169, 171.

S u m m a r y

A VARIATION OF THE AORTAL ARCH

The paper gives some data on the variations of the sites of emergence of the arterial branches coming from the arch of the aorta.

The study comprises 180 subjects, 100 male and 80 female, ranging from newborns to the age of 96 years. In 14 cases (7.7%) arteria vertebralis sinistra emerged directly from the arch. This variation was encountered in two types:

Type I – arteria vertebralis sinistra was located between a. carotis communis sinistra and a. subclavia sinistra. This type was found in 12 subjects (6.6%).

Type II – arteria vertebralis sinistra was located between truncus innominatus (7) and a. subclavia sinistra. This type was less frequent – only in 2 subjects (1, 1%).

Résumé

A PROPOS D'UNE VARIATION DE L'ARC AORTIQUE

L'auteur de la présente communication fournit des données à propos d'une variation des branches qui sortent de l'arc aortique.

Objet de son étude sont 180 sujets, dont 100 mâles et 80 femelles, depuis des nouveaux-nés jusqu'à des personnes âgées de 98 ans. Dans 14 cas (7,7%) il a observé que l'arteria vertebralis sinistra sortait directement de l'arc aortique. Cette variation constatée est de deux types:

Type I. — L'arteria vertebralis se trouvait dans ce cas entre les arteries carotis communis sinistra et arteries subclavia sinistra. Cette variation intéressait 6,6% des cas.

Type II. — L'arteria vertebralis se trouvait dans ce cas entre truncus innomatus (7) et arteries subclavia sinistra. Cette variation rare intéressait deux cas seulement (1,1%).

NJE RAST ME SINDROMEN, DISPLAZI OLFAKTO-GJENTITALE

(Sindroma Kallman – De Morsier)

— VLADIMIR LUÇI —

(Instituti i Kërkimeve Mjekësore Ushtarakë – Tirane)

Megjithëse në kuadrin e hipogonadizmit, sindroma displazi olfakto-gjenitale mendohet se ze një vend të rëndësishëm, që një autor (2) e gjen faktin se i sëmuri shpeshherë i negligzon shqetësimet e veta. Për këtë qëllim në këtë studim do të mundohemi të përskruajmë kriteret e kësaj sindrome.


Prania e anomisë, në formë të rralla të hipogonadizmit, është përmëndur qysh me 1856, por më 1944 disa autori e përpunuani këtë sindromë si nozologji më vete (5, 6, 7). Më 1954 disa autori përskruan karakterin e dëmtimive anatomike në këta të sëmurë dhe e emërtuan displazi olfakto-gjenitale, emër me të cilin njihet kryesishët në vendet evropiane.

PERSHKIMI I RASTIT

I sëmuri B. S., vjeç 41, i pamartuar, paraqiste një mungesë të plotë të pilozitetit të nje fytyre, trup dhe anësë; në setullia piloziteti ishte pak i shprehur, në pubis gjithashtu i rrallë, më topografi feniore. Lëkura kish një ngyrë të verdhë si dylli. Zëri i hollë, metalik. Organet gjenitale me aspekt infantil, në skrotum palpohej vetëm një testikul (testikuli i majte), shumë i vogël në prekje sa një kokër misri, epididimusi pak i zhvilluar. Karakteristikat trupore paraqesin një aspekt makrokeletalik shumë të shprehur, që, sic shihet, në morfogramen, marrin pamjen e gërmës M, e cila është vçori për eunukoidizmin. I semuri referoi se kish mungesë të plotë të nuhatjes si pier erërat e mira, ashtu dhe për erërat putride të konstatuara qysh në moshë të vogël, për të cilën është konsultuar me mjekët nga ana e prindërve. Gjithashtu i sëmuri kish mungesë të plotë të erekzionit dhe ejakulacionit.

Me qëllim që të studjonim integritetin e aksit hipofizo-surenalian dhei hipofizo-gonadal, i sëmuri iu nënshtrua ekzaminimeve biologjike, dozimi i 17 ketosteroleve, 17 OH kotrikosteroideve, estrogeneve në urinën e 24 orëve si në gjendje bazale ashtu dhe pas stimulacionit me ACTH (75 UI ACTH në 500 ml. solucion fiziologjik i.v. për 8 orë), testi me Metopyron (4,5 gr. të ndara çdo 3 orë, gjatë 24 orëve), frejmimi me dexametasin (3 mg. për 5 dite), testi i stimulacionit me gonadotro-

Slike (1 a b)



pine korionike (1500 U në ditë për 5 ditë, duke mbajtur të frenuar shteteralen me deksametason), rezultatet e të cilave i paraqesim në pasqyrën nr. 1.

Pasqyra nr. 1

	Gjendje bazale	Stimulimi ACTH	Metopyron	Frenimi dexametason	Stimulimi H C G
17 K.S.	9,7	17,2	15,2	7	2,55
17 OH K.S.	5,6	16,5	9,5	—	3,9
Estragonjet	33,0	30,0	—	15,2	17,8

- 1) Steroidograma e 17 ketosteroideve rezultoi si më poshtë:
1,7 ng/24 orë (1,2-1,6)
- 2) Androsteroni 1,7 ng/24 orë (3,5-5,3)
- 3) Etokolonoloni 3,6 ng/24 orë (3,4-5,1)
- 4) 17 K.S. e oksigenuara në Cl₁ 1,1 ng/24 orë (2,4-3,1).

Kampi viziv, fundus i syrit dhe vizusi ishin normalë, tregjrat i dallonte mirë. Në grafiti i kraniumit nuk u vu re ndonjë ndryshim patologjik, E.E.G. ishte pa ndryshime. Ekzaminimet e sistemeve dhe organeve të tjera rezultuan normal.

Diskutimi i rastit. — Siç shihet, në të sëmurin tonë, hipogonadizmi është problemi kryesor për t'u trajtuar. Ai karakterizohet nga shenjat e një pamjafftueshmëri androgjenike, që reflektohen në pamjen e jashme të sësemurit, me mungese të pilozitetit, infantilizëm të organeve gjennitale, mungesë të ereksioneve dhe ejakulacioneve, përmasave trupore, që kryejnë aspektin e një eunukoidizmi makroskeletik. Këto karakteristika të përshtakuara dhei nga autorë të tjera (2, 4, 5, 6), rrjedhin për pasoje e një mungesë në prodhimin e hormoneve androgjene, si rezultat i së cilës do të kemi defekte në maturacionin pubertar dhe mosifkimin e kartilagove të rrithjes.

Faktor tjetër që u vu re në të sëmurin tonë ishte mungesa e plotë e nuhatjes ndaj substancave aromatike të ndryshme. Prania e një anomaliie të tillë është vegeri e kësaj sindrome dhe tregon për praninë e një lidhjeje ndërmjet pjesëve të sipërme të sistemit nervor qëndror me boشتin hipotalamo-hipofizo-gonadal. Studimet anatomike të kryera nga disa autorë (cituar nga 5) tregon për një agjenezi të plotë ose të pjesësme të gjirit olfaktor, duke interesuar veganerisht bulbet olfaktiv, limbuset, hipokampin, *girus rectus* etj. Në ato raste, ku objekt studimi eshtë bërë dhe hipotalamusi, është parë dhe hipoplazi e tij.

Lidhja e anomisë dhe deficiencës gonadotropike mund të shpijegohet si një çregullim i zhvilluar për shkak të lidhjeve të ngushta ndërmjet mukozes nazale dhe faringeale, hipofizës, rhinencefalosit dhe hipotalamut.

Në të sëmurin tonë kishte gjithashqti një mungesë të zbritjes së testikulit të djathtë në skrotum. Prania e kriptorkidise, në rastet me sindromen displazi olfakto-gjenitale, është vënë re edhe nga autorë të tjere (2, 6, 7). Në këto raste, frekuanca e kriptorkidisë tregon se hipogondizmi është embrio-fetal, si rezultat i një insuficience gonadotropike, sikurse ndodh p.sh. tek anencefaliqet, që përgjithësisht, janë kriptorkidikë. Por studimet e bëra për të përcaktuar shmanget kronozomike me anë të kromatinës seksuale dhe kariotipit nuk kanë venë në dukje ndryshime nga norma (1, 5, 7).

Rezultatet e ekzaminimeve biologjike vunë në dukje një prodhim minimal të normës në rastin e 17 ketosteroideve. Steroidograma tregon një ulje të prodhimit të andresteronit dhe nivel minimal të etiokolonolontit, të cilat janë metabolite të androgjenikëve testikulare.

Estrogjenet totale janë të rritur. Studimet biologjike dhe radioimmunologjike, të kryera nga autorë të tjere, kanë treguar një prodhim minimal të 17 ketosteroidave dhe një ulje ose nivele minime të normës përgonadotropinat si për FSH ashtu dhe për LH. (5, 6). Provat per stimulimin e prodhimit të gonadotropinave me anë të citratit të *clomiphene*

ose me anë të faktorëve që rues hipotalamikë (LHRH) kanë rezultuar të paefektshme (4, 6, 9).

Gjatë ekzaminimeve biologjike dinamike, në rastin tonë, u vu re një mungesë e sensibilitetit periferik testikular ndaj dhënies ekzogjene të gondadotropinave korionike. Përgjithësisht në rastet e studjuara nga autorë të tjerë është vënë re një përgjigje e mirë testikulare ndaj gondotropinave korionike, me realizim të virilizmit si dhe të funksionit spermatozogenetik (4, 5, 6), ose të funksionit ovarien tek grata deri në shtatzëni (9). Por gjithashtu, në disa raste, është vënë re një mungesë e përgjigjes testikulare ndaj stimulit të jashën me gondadotropinë korionike, kryesisht tek ata që paraqisin kriptorkidi (6, 7, 8). Kjo gjë, sikurse edhe për rastin tonë, flet për një démtim të rende testikular të gërshtuar me démtim të regionit hipotalamo-hipofizar.

Përfundim. — Sindroma e displazisë olfakto-gjenitale është e rrallë, por u has edhe në praktikën tonë. Kjo sindromë ka rendësi të nijhet, sepse mund të kurohet në drejtim të rivendosjes së virilizmit dhe të kthimit të funksionit spermatozogenetik.

Dorëzuar në Redaksi më 15.VI.1979

BIBLIOGRAFI

- 1) Gako B.: Kronatina e sekritit në norme dhe në disa sëmundje kromozomale. Letini UT — Seria shikencat mjekësore 1977, 1, 13.
- 2) Fromantin M.: Limites et anomalies du syndrome de De Morsier. Ann. D'Endocrin. 1975, 2, 109.
- 3) Gayral M. N.: Les oligoasthenospermies. Conc. Medic. 1974, 33, 4731.
- 4) Geunes J. L.: Le traitement des impuérances hypogonadotropes. Rev. Franc. Endocr. Clin. 1976, 1, 77.
- 5) Guinet P.: Le syndrome olfacto-génital. Rev. du Prat. 1976, 35, 2475.
- 6) Labhart A.: Testis. Clinical endocrinology. Spring Verlag, New York 1974, 470.
- 7) Netter A.: Le syndrome de De Morsier-Kallman ou dysplasie olfacto-génitale. Nouvelle Press. Medicate 1972, 2, 119.
- 8) Reichlin S.: Neurogenic hypogonadism in the male. Textbook of endocrinol, Saund. Comp. New York 1974, 818.
- 9) Tagaiz J.: Hypogonadotropic hypogonadism associated with anosmia in the female. New Engl. Journ. Med. 1970, Vol. 283, 1326.

Summary

(The Kallman — De Morsier syndrome)

A case of the olfacto-genital dysplastic syndrome is described. Its clinical aspect is presented with fall of 17-ketosteroids and rise of total oestrogens. The dynamic study of the gonado-hypophyseal axis showed a lack of testicular peripheral sensitivity to gonadotropins.

Résumé

UN CAS DE DISPLASIE OLFACTO-GENITALE

(Syndrome Kallman – De Morsier)

L'auteur du présent article décrit un cas de dysplasie olfacto-génitale. Il présente l'aspect clinique d'un hypogonadisme avec une baisse des 17-ketostéroïdes et une hausse des estrogènes totales. L'étude dynamique de l'axe hypophyse-gonade a montré un manque de la sensibilité testiculaire périphérique à l'égard des hypothalamotropes.

SALMONELLA TYPHIMURIUM E IZOLUAR NGA L. CEREBROSPINAL

— SOFIE DOKO — LILI GOGA —

(Drejtoria e Higjienës dhe Epidemiologjisë — Fier)

Salmonelet zoterojnë një farë potenciali patogjen si për njerezit ashtu dhe për kafshët. Këto prekin çdo ind dhe organ, duke dhënë tablo klinike të pjeshtime ose të plota nga ana simptomatologjike, që nuk janë gjithmonë brenda kuadrit klinik klasik salmoneloz. Salmonelozat shfaqen me simptoma klinike atipike të sëmundjeve nga më të ndryshmet, që shpesh gjijnë në gabime diagnostike.

Forma gripale salmoneloze gjithmonë e më shpesh dhet gabimisht diagnostikohet si grip gjëri në 10,8% të rasteve. Në shpërbinte të tjera salmoneloze, këto gabime kanë qenë të theksuara: 32,4% dhe 84% (6). Në këtë drejtim shumë të rëndë janë format septike kur salmonelet, ja-pin dëntime si bronkopneumonja, perikarditi, pleonefriti, pleuriti dhe dëntime si osteomielit, meningjji, apandesit, empiemë pleurale dhe vatrat pulmonare.

R A S T I V N È

I sëmuri A.P., me moshë 2 muaj, me kartell nr. 1191 shtrohet në spital më 8 mars 1977. Diagnoza e dërgimit: suspect *meningitis*. Diagnoza përkohshme: *meningitis acuta et anemia secondaria*. Diagnoza përfundimtare: *meningitis purulenta et anemia secondaria*.

Krahas ekzaminimeve të tjera, i sëmuri ka bërë ekzaminime të L. cerebrospinal më 10 mars 1977 që ka rezultuar: i turbullt. Kultura parëtore në agar-gjak. Në ekzaminimin mikroskopik u vëretjetën elemente qelizeore pa mikrobe. Koprokulturat e kryera në datat 14 mars 1977 dhe 30 prill 1977 kanë rezultuar negative, kurse nga koprokultura e tretë e datës 12 maj 1977 u izolua salmonella typhimurium rezistente ndaj antibiotikëve streptomycin, CAF, Tetraciklin, neomicin dhe kanamicine me strukturë antigenike 0-1-4-5-12-H i 1/2.

Më 18 maj 1977 bëhet ekzaminimi i dytë i L. cerebrospinal, i cili, nga ana makroskopike paraqitet i turbullt dhe sanguinolent. Në ekzaminimin mikroskopik u vëretjetën elemente qelizeore (neutrofile) dhet qehza bakteriale në formën e bacilleve. Kultura në terrenin agar-gjak, pas 24 orëve, paraqitet në formën e kolonive të rrumbullakta, të mystës, të lëmuara, jottansparente me anë të irregullta, pa hemolizë, ngjyrë gri të hapur. Karakteristikat e kolonive dhet pamja mikroskopike nuk përpunohen me të dhënët e një *Escherichia coli*.

Për identifikimin e kulturës së izoluar, e kalluat atë në terrene të posaçme për bakterit enterobakteriaceale, në dezoksikolat citrat agar.

Pas 24 orë inkubimi në terren u vërejtën koloni karakteristike për salmonelat. Pas provave biokimike dhe serologjike u vërtetua izolimi i salmonella typhimurium, që kishte të gjitha vëtitë biokimike, antigjenike dhe rezistencën ndaj antibiotikëve të njëjtë me kulturën e izoluar nga koprokultura 8 ditë më parë. Po ky tip salmonella u izolua edhe nga hemisferat e trurit pas vdekjes.

Në rastë të tillë, koprokulturat kanë rëndësinë e tyre diagnostike, megjithëse ato në sepsis janë negative, kurse hemokulturat vëtëm internatente janë pozitive (1). Krahas rasteve karakteristike me lokalizime intestinale në repartin e neonatëve, janë vërejtur raste septicemie me diare, bronkopneumopati dhe forma të meningjitet purulent (3). Eshtë vërtetuar ekzistencë e disa serotipave të salmonelave, të cilat shkaktojnë forma septike piemike dhe të meninxijit purulent (5).

Formata septike salmoneloze me ecuri të rrufeshëm jorrallë gjonjë drejt vdekjes. Mbi karakterin septic salmoneloze, në këtë raste, dëshmoi nxjerja në kulturë të pastër e salmonella typhimurium nga muri i zo-rreve, mushkërrive dhe trurit të vdekurve (6).

Në klinikë duhet të kihet parasysh edhe fakti se krahas pakësimit të theksuar të rasteve në salmonella typhi po vërehet një rritje e së-mundshmërisë nga të ashtuquajturat Salmonella minore, që në shumë raste nuk sillojn si minore (ku futet edhe salmonella typhimurium) (4).

Në rastin tonë nuk mundëm të bërim edhe mikrokulturen e rekombanduar për këto raste (2).

PËRFUNDIMI

- 1) Në të gjitha rastet e eksaminimit të *L. cerebrospinal* të kërkohet edhe për mikrobet e gjinisë salmonella, sidomos në enteritet me natyrë ose jo salmoneloze, në mënyrë të vegantë në strukturat e fëmijëve.
- 2) Diagnostikimi sa më i hershmë i salmonelozave ka vlerë të madhe epidemiologjike, klinike dhe parandalon shumicën e ndërlidhimeve mundshme dhe sidomos gjendjet septike.

BIBLIOGRAFIJA

- 1) Berengo A.: Clinica ed terapia di salmonellosa. Terapia periodica bimestrale di informazione 1976, 61, 437.
- 2) Cilka St.: Salmonelat. Mikrobiologjia mijekësore. Tirane 1972, Vol. II, 345.
- 3) Careddu J.: Le salmonellosis nella pediatria. Terapia periodica bimestrale di informazione 1976, 61, 437.
- 4) Dibra A. e bp.: Probleme aktuale të epidemiologjisë dhe profilaksisë së salmonelozave. Higjiena dhe Epidemiologjia 1976, 1, 80.
- 5) Grillo V.: Kuadri klinik epidemiologjik dhe trajtimi i salmonelozës në fëmijet e moshës se gjirit. Shendetësia popullore 1975, 4, 37.

6) Shur J. V.: Zabolevanie salmoneloznij etiologi. Moskva 1970, 137.

7) Vaglia A. e bp: Terapia delle salmonellosi. Giornale di malattie infettive e parassitaria 1976, vol. 28, nr. 6, 354.

Summary

SALMONELLA TYPHIMURIUM ISOLATED FROM THE CEREBROSPINAL FLUID

A case is described of purulent meningitis in a child two months old from whose cerebrospinal fluid *Salmonella typhimurium* was isolated.

The authors point out that in the bacteriological examinations of the cerebrospinal fluid, apart from the common agents of purulent meningitis, members of the *Salmonella* genus should be looked for.

Résumé

SALMONELLA TYPHIMURIUM ISOLEE DE L. CEREBROSPINAL

Les auteurs décrivent un cas d'isolation de *Salmonella Typhimurium* de L. Cerebrospinal à un enfant âgé de deux mois, hospitalisé avec la diagnose meningitis purulente.

Les auteurs tirent l'attention que dans les examens bactériologiques de L. Cerebrospinal, parallèlement des autres bactéries, doit chercher encore et pour les microbes de *Salmonella*.